



Rama: 146 milionë euro nga programi IPARD 3, moment i rëndësishëm drejt rilindjes së Bujqësisë

Faqe 5



Zvicra dhe Shqipëria nisin fazën e re të bashkëpunimit për katër vitet e ardhshme

Faqe 2



Qeveria shqiptare me mbështetjen e Japonisë dhe FED invest, synon zgjerimin e financimit dhe digjitalizimin e sektorit rural

Faqe 6



AGROBIZNESI



Rr. "Qemal Stafa", P. 9-katësh, Nr. 70, Kati 2, Pazari i ri, Tiranë.
Tel: +355 4 2 251 910 /911
Email: info@fedinvest.al
kontakt@fedinvest.al
www.fedinvest.al

BOTIM I KËSHILLIT TË AGROBIZNESIT SHQIPTAR

Adresa: Rruga "Mine Peza", Pallati 87/3, Hyrja 1, Kati i parë, Tel/ Fax: 2229445
E-mail: infokash@yahoo.com www.kash.org.al

15-ditëshi i dytë i muajit maj 2022

Viti i shtatëmbëdhjetë i botimit - Nr. 438
Çmimi 125 lekë

E përdyjavshme e pavarur

REZOLUTË E FORUMIT TË AGROBIZNESIT PËR ÇËSHTJET E BUJQËSISË TRYEZA TEMATIKE DHE FORUMI I AGROBIZNESIT "BUJQËSIA, TURIZMI RURAL DHE MJEDISI NË ZONAT RURALE NË SHQIPËRI"

Këshilli i Agrobiznesit Shqiptar, nismëtar i Forumit të radhës për çështjet e bujqësisë, organizuar në Lushnje, me pjesëmarrjen e aktorëve shumë të rëndësishëm, që kanë kontribuar në vite dhe vijojnë të kontribuojnë në këta sektorë, parashtrori rezoluten me objektivat kryesore për të përballuar pasojat e krizës që u shkaktuan nga tërmeti, pandemia covid 19, përkeqësimi i kushteve klimatike, paketa fiskale 2022, rritja e çmimeve nga lufta në Ukrainë

RISI ALBANIA NJË PROJEKT I AGJENCISË ZVICERANE SDC

Standardet për kultivimin e bimëve medicinale dhe aromatike në Prrenjas, perspektiva për agrobizneset dhe të rinjtë



Qeveria Zvicerane kontribut për zhvillimin rural në Shqipëri



Faqe 2

KËNDI I EKSPERTIT

Këshilla për mbrojtjen e bimëve

Përgatiti Prof. Ass. Enver ISUFI
Instituti i Bujqësisë Biologjike, Durrës

Faqe 7



TEMË E DITËS

Barrierat për industrinë e vajit të ullirit - Subashi: Kostot shtesë do të reflektohen në çmime më të larta!

Faqe 4

KËNDI I EKSPERTIT

- Ndikimi i blegtorisë në mjedis Fq.11
- Operacionet e gjelbra në hardhi Fq.11
- Këshilla për fermerët që mbarështojnë bagëti të imta Fq.12
- Kalendari bujqësor, muaji qershor 2022 Fq.13

Krifca: IPARD injektoi kapital në bujqësi, rritje të prodhimit dhe të cilësisë



Faqe 5

SIGURI USHQIMORE

Përdorimi i pesticideve, KLSH: Mungojnë trupat kontrolluese, ngërc për sigurinë ushqimore



Faqe 4

Standardet për kultivimin e bimëve medicinale dhe aromatike në Prrenjas, perspektiva për agrobizneset dhe të rinjtë

Bimët mjekësore dhe aromatike të Shqipërisë kanë potencial të madh për eksport dhe punësim. Gjatë vizitës së saj në Shqipëri, Patricia Danzi, Drejtoreshë e Përgjithshme e Agjencisë Zvicerane për Zhvillim dhe Bashkëpunim SDC, u ndal

zhvillim të qëndrueshëm dhe punësim, duke adresuar kështu Objektivin 8 të Objektivave të Zhvillimit të Qëndrueshëm të Kombeve të Bashkuara (SDG 8).

Agrobiznesi kontribuon rreth 20% të Prodhimit të Brendshëm Bruto të Shq-

ion Euro, duke e bërë atë një nga kontribuesit më të mëdhenj në eksportet bujqësore.

“Kjo iniciativë u mundëson të rinjtë të diversifikojnë burimet e tyre të të ardhurave ndërsa mbështet një zanat tradicional shqiptar”, u shpreh Danzi.

RisiAlbania synon të gjenerojë mundësi punësimi për të rinjtë në Shqipëri, duke mbështetur rritjen e sektorit privat, ofrimin e trajnimeve jo-formale të orientuara drejt tregut dhe strukturat e ndërmjetësimit të karrierës që funksionojnë më mirë.

në AgroMAP, partner i RisiAlbania në Prrenjas, që kultivon dhe eksporton bimë mjekësore dhe aromatike në Zvicër, Gjermani dhe Francë.

ipërisë dhe krijon punësim për rreth 40% të popullsisë. Ka një potencial të jashtëzakonshëm për punësimin e të rinjtë dhe

Aktualisht, RisiAlbania po punon ngushtësisht me tre eksportues: Biobes, Agro-Map dhe Bioalba. Agro-Map, i vendosur në Prrenjas, synon të stimulojë kultivimin me kontratë dhe ofrimin e shërbimeve për fermerët, duke filluar nga fidanë të certifikuar, në shërbimin e tharjes dhe mbështetje agronomike dhe financiare. Agro-Map ka qenë pionier në realizimin e investimeve në zonën e Kolonjës falë mbështetjes së Bashkisë. Gjatë kësaj periudhe ata kanë arritur të kontraktojnë gjashtë fermerë të rinj dhe ata janë duke punuar në krijimin e një departamenti R&D brenda kompanisë.

Ndërsa Bashkia e Kolonjës ka nënshkruar me parë një Memorandum Mirëkuptimi me RisiAlbania, ku Bashkia do të promovojë Kolonjën si një destinacion për të tërhequr investime në BMA me kusht që të ofrojnë mundësi pune cilësore për të rinjtë. Në lidhje me të ardhmen, Kryetari i Bashkisë së Kolonjës theksoi rëndësinë dhe potencialin e agroturizmit për rrethin e Kolonjës.

grupeve të disavantazuara në zonat rurale. Për këtë arsye, që nga viti 2013, RisiAlbania mbështet agrobizneset që veprojnë në dy nënsektorë: fruta dhe perime dhe BMA. Bimët Medicinale paraqesin një nënsektor shumë të rëndësishëm për eksportet dhe punësimin në zonat rurale. Sipas INSTAT, në vitin 2018, eksporti i BMA arriti në 37 Mil-

Bimët mjekësore një potencial i jashtëzakonshëm për punësimin e të rinjtë dhe grupeve të disavantazuara në zonat rurale. Aktualisht, RisiAlbania po punon ngushtë me tre eksportues: Biobes, Agro-Map dhe Bioalba. Agro-Map, i vendosur në Prrenjas, synon të stimulojë kultivimin me kontratë dhe ofrimin e shërbimeve për fermerët, duke filluar nga fidanë të certifikuar, në shërbimin e tharjes dhe mbështetje agronomike dhe financiare.

Këshillimi i karrierës, Bashkia u ofron të rinjtë listën me 100 profesionet më të kërkuara

Tregu i punës ka pësuar ndryshime të forta, veçanërisht pas pandemisë së COVID-19. Profesionet të vjetra po mbyllen dhe të tjera po krijohen. Një dukuri që po ndodh jo vetëm në Shqipëri, por në të gjithë botën. Të rinjtë ndodhen përpara dilemave se çfarë dege duhet të zgjedhin për profesionin e tyre të të ardhmen.

Për të bërë zgjedhjen e duhur, ajo që shërben është këshillimi i karrierës. Një proces që në fakt nuk nis me zgjedhjen për

arsimin e lartë, por shumë më herët. Dhe për këtë nevojitet këshillimi i karrierës, si forma e duhur drejt profesionit.

Anisa Subashi, drejtoreshë e Drejtorisë së Shërbimeve Sociale në Bashkinë Tiranë, thotë se pushteti lokal u ka ardhur në ndihmë të rinjtë, por jo vetëm. “Kemi përgatitur kartolina për 100 profesionet më të kërkuara të tregut të punës. Të cilat shoqërohen me informacionet bazë, kush janë kushtet që duhet të

plotësosh, kriteret dhe si është tregu i punës. Kemi edhe tre teste të standardizuara, profesionale, në mënyrë që të rinjtë të orientohen drejt karrierës”, tha Subashi në A2 Business.

“Kjo listë dhe ky këshillim nuk është vetëm për të rinjtë, por edhe për ata persona që janë mbi 40 vjeç, por që kanë nevojë për një orientim. Kemi specialistë shumë të mirë aty, që mund t’i japin gjithkujt drejtimin e duhur për karrierën”.

Zvicra dhe Shqipëria nisin fazën e re të bashkëpunimit për katër vitet e ardhshme

Një program i ri bashkëpunimi zvicerano-shqiptar për të cilin Zvicra përkushton fondin prej 105 milionë franga zvicerane, u lançua sot me synim kontributin për demokraci, zhvillim ekonomik, shëndetësi dhe ndryshimet klimatike

Ministrja e Financave dhe Ekonomisë Delina Ibrahimaj dhe Drejtoresha e Përgjithshme e Agjencisë Zvicerane për Zhvillim dhe Bashkëpunim SDC,

një pronësi të përbashkët të këtij programi. Ne gjithashtu shohim përpara drejt zbatimit të tij së bashku”, tha Drejtoresha e Përgjithshme e Agjencisë

këpunimit, Zvicra përkushton 105 milionë franga zvicerane për mbështetjen e qeverisjes demokratike, zhvillimit ekonomik, shërbimeve infrastruktur-



Patricia Danzi, lançuan sot një fazë të re të programit të bashkëpunimit midis dy vendeve.

“Programi i ri i bashkëpunimit midis Zvicrës dhe Shqipërisë është një tregues tjetër i partneritetit të ngushtë midis dy vendeve tona. Shumë është arritur në katër vitet e shkuara. Jam e sigurtë që shumë do të arrihet gjithashtu edhe në katër vitet e ardhshme. Programi i ri bazohet dhe vijon me mbështetje në fushat kyçe të demokracisë, ekonomisë, shërbimeve infrastrukturore dhe shëndetësisë”, tha Ministria e Financave dhe Ekonomisë Delina Ibrahimaj.

“Sot jam e gëzuar dhe nderuar që lançoj me të gjithë ju programin e ri të bashkëpunimit zvicerano-shqiptar 2022-2025. Partneriteti është tipari thelbësor i bashkëpunimit tonë. Shumë nga ju (qeveria shqiptare, shoqëria civile, sektori privat, partnerët për zhvillim) morën pjesë në përpunimin e këtij programi të ri të bashkëpunimit. Ju falënderoj për kontributin. Ne kemi

Zvicerane për Zhvillim dhe Bashkëpunim SDC, Patricia Danzi.

Në aktivitetin lançues ishin prezent disa ministra

oe dhe ndryshimeve klimatike, dhe shëndetësisë në Shqipëri. Ai mbulon periudhën 2022-2025 dhe do të fokusohet në reforma dhe rezultate në fush-



të qeverisë, deputetë, dhe kryetarë bashkie, ndërsa delegacioni i qeverisë zvicerane përfshiu si përfaqësues nga Sekretariati Zviceran i Shtetit për Çështjet Ekonomik SECO, Z. Martin Saladin, Drejtues i Operacioneve.

Sipas programit të ri të bash-

at e demokracisë, shtetit ligjor, klimës së biznesit dhe kushteve të jetesës për qytetarët.

Zvicra është një nga partnerët dhe donatorët dypalësh më të rëndësishëm për Shqipërinë veçanërisht në fushat e qeverisjes demokratike, mbështetjes makroekonomike dhe shëndetësisë.

Prodhuesit e qumështit synojnë eksporte drejt vendeve të CEFTA-s

Fermerët dhe sipërmarrësit përmes skemave mbështetëse po rrisin investimet në teknologjitë e reja dhe modernizimin e fer-

sosistikuara.

Sipërmarrës të industrisë së qumështit, diskutuan gjatë një takimi në Tiranë, për zgjerim-

teksa u ndalën në “sfidat dhe mundësinë e krijimit të zonave rajonale ekonomike, për rritjen e eksporteve”.

Përfaqësues të Autoritetit Kombëtar të Ushqimit dhe Ministrisë së Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural, organizatorë të këtij takimi me biznese të prodhimit dhe përpunimit të qumështit, u njohën me kërkesat e biznesit mbi zgjerimin e tregut, për të eksportuar drejt vendeve CEFTA-s.

Ekspertët e MBZHR theksuan se, dialogu me palëve është kyç për të zgjidhur problematikat dhe kthyer ato në një mundësi, për aftësitë konkurruese të bizneseve prodhuese/përpunuese



mave, si domosdoshmëri e avantazheve konkurruese në tregjet europiane dhe akses në tregjet e

in e eksporteve të produkteve të bulmetit “Made in Albania” drejt vendeve CEFTA-s,

(Vijon në faqen 4)

REZOLUTË E FORUMIT TË AGROBIZNESIT PËR ÇËSHTJET E BUJQËSISË

TRYEZA TEMATIKE DHE FORUMI I AGROBIZNESIT “BUJQËSIA, TURIZMI RURAL DHE MJEDISI NË ZONAT RURALE NË SHQIPËRI”

Këshilli i Agrobiznesit Shqiptar, nismëtar i Forumit të radhës për çështjet e bujqësisë, organizuar në Lushnje, me pjesëmarrjen e aktorëve shumë të rëndësishëm, që kanë kontribuar në vite dhe vijojnë të kontribuojnë në këta sektorë, parashtrori rezoluten me objektivat kryesore për të përballuar pasojat e krizës që u shkaktuan nga tërmeti, pandemia covid 19, përkeqësimi i kushteve klimatike, paketa fiskale 2022, rritja e çmimeve nga lufta në Ukrainë

Forumi i Agrobiznesit “Bujqësia, Turizmi rural dhe Mjedisë në zonat rurale” u zhvillua në datën 20 maj 2022, në sallën e Kinoteatrit “Vaçe Zela” në Lushnje. Forumi ishte vijim i punës dhe konkluzioneve paraprake të arritura para, gjatë dhe mbas zhvillimit të “Tryezës Tematike” të dt. 29 prill 2022, mbajtur në Kompleksin Agroturistik UKA FARM në Laknas, Tiranë. Gjithashtu Forumi i agrobiznesit i zhvilloi punimet në kuadër të Panairit “**Diët e Bujqësisë 2022**”, që u organizua nga Kompania “ICEBERG” në Lushnje, nga dt. 19 - 21 maj 2022.

Mënyra dhe forma e organizimit, pjesëmarrësit në Tryezën tematike dhe në Fo-

rumin e Agrobiznesit ishin gjithëpërfshirëse, të mirëkoordinuar me disa aktorë të rëndësishëm të sektorit të bujqësisë, turizmit rural dhe mjedisit në zonat rurale. Të cilët sollën ide dobiprurëse, dhanë këshilla e bënë vlerësime të situatës, u bënë pyetje e diskutime të lira, rrahje mendimesh e propozime dhe në përfundim të Tryezës tematike u arrit në hartimin e draftit të një P/Rezolute e cila u plotësua dhe miratua në Forumin e Agrobiznesit. Temë kryesore dhe objekt i diskutimeve në Tryezën tematike dhe Forumin e Agrobiznesit ishin në katër shtylla kryesore:

I. Procesi i **Kooperimit dhe Koordinimit insitucional**, jo

vetëm midis hallkave të sektorit bujqësisë, turizmit rural dhe



mjedisit në zonat rurale, por edhe me sektorët e tjerë të Ekonomisë së Ushqimit, konkretisht

atë të “**Blegtorisë**”, “**Peshkimit dhe Akuakulturës**”, “**Agrobi-**

znesit”, “**Agropërpunimit**”, “**Bimëve Mjekësore, Aromatike dhe Bletarisë**”, “**Agro-**

turizmit, Agropylltarisë dhe Turizmit kulturor zonat rurale”, “**Tregjeve Agro - Blegtorale**”, “**Financës, Mikrofinancës**” dhe “**Përmirësimit të legjislacionit që impakton zonat rurale**”.

II. Fusha e **Mekanizimit, Inovacionit dhe Dixhitalizimit**,

III. Fusha e **Financës, Mikrofinancës, Disbursimi të fondeve grant**.

IV. Fusha e **Përmirësimit të Legjislacionit dhe Përafrimit me atë të BE**.

KASH si nismëtar i forumit të radhës, bazuar në tematikën e përzgjedhur, kish përgatitur dhe paraqiti një informacion

paraprak së bashku me P/Rezolutën, të cilat u botuan në dy numra të Gazetën Agrobiznesi dhe ju shpërndan paraprakisht të gjithë pjesëmarrësve në “Tryezën tematike” të dt. 29 prill 2022, si dhe Forumit Agrobiznesit dt. 20 maj 2022 në Lushnje. Gjithashtu këto dokumente iu dërguan gjithë të zgjedhurve në bordet drejtuese dhe ekspertëve me përvojë të shoqatave anëtare të KASH dhe të tjerë, që kontribuan në suksesin e arritur në zhvillimin e Tryezës tematike dhe Forumin e Agrobiznesit.

Forum i Agrobiznesit në Lushnje filloi me paraqitjen e dokumentit në vijim të P/Rezolutës nga **Kryetari i KASH Z. Agim Rrapaj**.



KASH, mbasi organizoi dhe realizoi me sukses **Tryezën tematike dhe Forumin e agrobiznesit për Sektorin e Blegtorisë**, në zbatim të rekomandimeve dhe konkluzioneve paraprake që arriti ajo “Tryezë tematike”, të cilat u plotësuan dhe miratuan edhe në Forumin për Blegtorinë, e vijoi punën, për organizimin e “Tryezës tematike” dhe Forumin e radhës, **Bujqësia, Turizmi Rural dhe Mjedisë në Zonat Rurale**, me pjesëmarrjen e disa aktorëve shumë të rëndësishëm, që kanë kontribuar në vite dhe vijojnë akoma të kontribuojnë në këta sektorë. Pjesëmarrësit e “Tryezës tematike” arritën në konkluzion:

Bujqësia, Turizmi Rural dhe Mjedisë në Zonat Rurale janë dhe do të vijojnë të jenë edhe në të ardhmen sektorë me kontribute e potenciale të mëdha, me rëndësi të veçantë, në fushën e Ekonomisë së Ushqimit. Ata janë sektorë je-

REZOLUTË FORUMIT TË AGROBIZNESIT “BUJQËSIA, TURIZMI RURAL DHE MJEDISI NË ZONAT RURALE”

tikë, për rolin dhe rëndësinë që kanë, për rritjen e të ardhurave të familjeve fermerëve, për punësimin gjithëvjeter të Tyre dhe sigurimin e ushqimit, për rritjen e eksporteve dhe reduktimin e importit të produkteve ushqimore, si dhe për zhvillimin e qëndrueshëm të zonave rurale në tërësi. Gjithashtu janë sektorë me shumë ndikim, për forcimin dhe konsolidimin e sigurisë kombëtare, veçanërisht në kohë krize.

Informimi paraprak, dialogu dhe konsultimi me pjesëmarrësit gjatë procesit përgatitor disa mujor të “Tryezës tematike” para datës 29 prill 2022, diskutimet dobiprurëse në takimin e datës 29 prill 2022, organizuar në Kompleksin Agroturistik UKA FARM, si dhe shkëmbimi i ideve mbas takimit e ndihmuan dhe e nxitën KASH, që të vijoj procesin e komunikimit dhe konsultimit, që të përgatis paraprakisht një P/ Rezolutë, për ta diskutuar, plotësuar e miratuar në Forumin e e zgjeruar të Agrobiznesit. Forum që u programua dhe u mbajt në datën 20 maj 2022 në Lushnje, me një pjesëmarrje më të madhe të subjekteve private, që punojnë në këta sektor, me tematikë të njëjtë: **Bujqësia, Turizmi Rural dhe Mjedisë në Zonat Rurale**, me fokus kryesor diskutimi:

Procesin e **Kooperimit dhe Koordinimit**, Fushën e Mekanizimit Inovacionit dhe Dixhitalizimit, Fushën e Financimit dhe Disbursimit të Fondeve Grant, Fushën e Përmirësimit të Legjislacionit dhe Përafrimit me atë të BE.

Kooperimi dhe Koordinimi i punës deri tani është vlerësuar me shumë teorikisht, si një potencial shumë dobiprurës, por i pashfrytëzuar sa dhe si duhet në praktikë. Konsiderohet si një mundësi reale, për të mundësuar një programim dhe bashkëveprim më eficient midis hallkave në Sektorin e bujqësisë, Turizmit rural dhe Mjedisit në Zonat rurale. Gjithashtu vlerësohet me potenciale dhe kosto financiare të mundshme, për ta përballuar dhe futur në rrugën e zgjidhjes problematike e vështirë të këtij procesi, si nga sektori privat dhe ai publik.

Objektivat kryesorë që synojmë të arrimë, si rezultat i marrjes së disa masave konkrete, për ndryshimin e formës aktuale të organizimit të punës, përmes Procesit të Kooperimit dhe Koordinimit: Evidentimin e aseteve të fermerëve dhe subjekteve të paformalizuara, në Sektorin e Bujqësisë, (Bimët e arave, Drufrutorët), që kanë përfutur tokë bujqësore si-

pas Ligjit 7501 “Për Tokën” ose posedojnë tokë bujqësore produktive (duke filluar punën si projekt pilot në një qark), të cilët përmes procesit të kooperimit dhe koordinimit, gjatë zbatimit të disa masave konkrete, ti bindim se kanë potenciale e mundësi të kultivojnë gjithë sipërfaqen e tokës, të realizojnë tepriç më të madhe prodhimi, me më shumë garanci për shitjen e tyre në treg me çmime reale dhe të realizojnë më shumë të ardhura për njësi të sipërfaqes së tokës. Gjithashtu të rrisim eficientë e përdorimit të tokës bujqësore, të reduktojmë informalitetin dhe të rrisim numrin e të siguruarve në zonat rurale, përmes pajisjes së tyre me NIPT Fermeri, organizimin në shoqëri bashkëpunimi (SHB) dhe klastera, në federata dhe Konfederatë, përmes dhënies së asistencës falas veçanërisht për kualifikimin e stafit drejtues, për studime fizibiliteti dhe hartimin e plan bizneseve të subjekteve të tyre, t’u mundësojmë më shumë hapësira për disbursim grantesh, lehtësi fiskale dhe kreditim me interesa të ulëta, veçanërisht për fushën e mekanizimit, inovacionit dhe dixhitalizimit. Gjithashtu të fillojë procesi për amendimin e miratimitin e disa ligjeve dhe akteve nënligjore, për të garantuar

qëndrueshmërinë dhe vijimësinë e suksesshme në të ardhmen për aktivitetin e tyre.

Evidentimin e subjekteve individuale të paformalizuara, që punojnë aktualisht dhe atyre që kanë potenciale e mundësi të punojnë në sektorin e Turizmit Rural. Organizimin e Tyre në SHB, federata, konfederatë, dhe klastera, duke promovuar përvojën e mundësuar zbatimin në praktikë të arritjeve të disa modeleve eficientë egzistuese, veçanërisht në fushën e agroturizmit.

Evidentimin e subjekteve individuale, që operojnë në mjedisit dhe sektorin e përpunimit të mbetjeve organike në zonat rurale. Organizimin e tyre në SHB, federata, konfederatë dhe klastera, duke krijuar një model eficient, për t’i dhënë zgjidhje problemit të deodorizimit, grumbullimit të mbetjeve organike nga bimët, blegtorija, mbetjet e thata që rezultojnë nga përpunimi ujërave të ndotura e të tjera mbetje organike, me synim përpunimin e tyre për prodhimin e plehut organik të pastër dhe përmirësimin e mjedisit në zonat rurale.

Eksperienca dhe veprimtaria e Qarkut dhe Prefekturës së përzgjedhur si pilot të shërbejë edhe si një model bindës për avantazhet që vijnë nga

përmirësimi punës së procesit të kooperimit dhe **koordinimit të veprimtarisë** të SHB, federatave, konfederatës, dhe klasterave në Sektorin e bujqësisë, sektorin e Turizmit rural dhe përmirësimit të Mjedisit, për të gjitha Qarqet dhe Prefekturat në vend për:

Krijimin e kushteve më optimale, për rritjen e shkallës së mekanizimit, inovacionit dhe dixhitalizimit.

Përmirësimin e situatës së formalizimit, zbatimit me eficientë më të madhe të politikave fiskale dhe skemave të mbështetjes, rritjen e masës së kreditimit me kushte lehtësuese, si dhe atë të disbursimit të fondeve grant. Gjithshtu njohjen, përmirësimin dhe zbatimin e gjithë legjislacionit që impakton këta sektorë.

Përballimin me sa më pak vështirësi e kosto financiare pasojat negative të krizës, që kryesisht kanë ardhur edhe si rezultat i disa faktorëve objektivë, si ai i tërmetit të 26 nëntorit 2019, pandemisë Covid 19, influencës negative nga përkeqësimi i kushteve klimatike, konjunkturës së pafavorshme ndërkombëtare të rritjes galopante të çmimeve dhe së fundi edhe pasojat e luftës në Ukrainë. Në funksion të realizimit të objektivave të sipërcituara:

MBZHR i propozohet të bashkëpunojë me sektorin privat dhe:

TEMA TË DITËS

Gratë punojnë tokën, burrat bëjnë llogaritë - Bujqësia, gjinia femërore dominon si forcë punëtore, por pronarë janë meshkujt

Bujqësia është një prej sektorëve më të rëndësishëm të ekonomisë sonë. Por, si është i përfaqësuar ky sektor nga pikëpamja gjinore? Shifrat e përpunuara nga "Scan Intel" bëjnë me dije se gjatë vitit 2020 në këtë sektor janë punësuar 41.4% e grave dhe 31.8% e burrave. Edhe pse përqindja e grave të punësuar në sektorin e bujqësisë tregon për një rënie krahasuar me vitin 2019-të me 0.2 pikë përqindje, panorama tregon dukshëm se gratë e punësuar në bujqësi kanë peshë më të madhe se burrat. Nëse do ta analizonim punësimin e grave në sektorin bujqësor sipas vlerës absolute, nga 553,677 gra të punësu-

arit të Ndërmarrjeve", "Scan Intel" ka përpunuar të dhënat e ndërmarrjeve aktive në aktivitetin e bujqësisë sipas gjinisë së pronarit. Shifrat e vitit 2020 tregojnë se nga 49,053 fermerë të regjistruar, 43,536 ose 88.8% janë burra dhe 5,517 ose 12.7% janë gra. Sa i përket ndërmarrjeve në fushën e bujqësisë, pyjeve dhe peshkimit, nga 1,358 ndërmarrje aktive gjithsej, 1,118 ose 82.3% prej tyre kanë pronarë meshkuj, ndërsa 240 ose 17.7% kanë pronarë femra. Pra, nga rezultati i këtyre të dhënave të kryqëzuara me rezultatet e paraqitura më sipër kuptojmë se burrat janë pronarë e ndërsa gratë janë "të punësuarat e tyre" sa i përket

veterinari". Nga ana tjetër, po të nejtat të dhëna tregojnë se janë 5.2% e burrave të diplomuar në këtë fushë. Përsëri shohim se këto të dhëna mbështesin rezultatet e mësipërme.

Kuptojmë se gratë në Shqipëri janë aktore të rëndësishme të prodhimit bujqësor, dhe përbëjnë më shumë se gjysmën e forcave të punës në këtë sektor. Megjithatë, bujqësia ende ka probleme të thella. Gratë hasen me informalitetin, konkurrencën e pandershme, punën e papaguar, aksesin e ulët në pronësi si dhe vështirësi në përfitim dhe pensioneve. Një pjesë e mirë e popullsisë së vendit tonë është e përqëndruar në zonat rurale dhe aktiviteti i tyre kryesisht është bujqësor ose blegtoral. Po të flasim për pjesëmarrjen në forcat e punës, sipas anketës, gratë kanë më pak gjasa të marrim pjesë në treg. Arsyet që raporti jep për këtë inaktivitet të grave lidhen kryesisht me faktin se janë nxënëse apo studente, mund të jenë në trajnime të mëtejshme, duke përbushur detyrat shtëpiake, ose lidhet me mungesën e arsimimit të tyre në zonat rurale. Pra në këto kushte, për këtë pjesë të popullsisë zgjidhja është sektori bujqësor dhe gratë janë të detyruara të punojnë për të siguruar të ardhurat e nevojshme. Por, cili është sektori i dytë pas bujqësisë i cili zë peshën më të madhe në punësimin e grave në vendin tonë? Shifrat e raportit "Burra dhe Gra" nga Instat, tregojnë se 21.6% e grave janë të punësuar në sektorin e tregtisë, transportit, hoteleri si dhe shërbime të biznesit apo ato administrative.



ara gjithsej në vendin tonë, 229,222 prej tyre punojnë pikërisht në këtë sektor. Nga ana tjetër, nëse po të nejtin tregues e analizojmë për burrat shohim se nga 689,666 burra gjithsej të punësuar gjatë vitit 2020, 219,313 prej tyre janë të punësuar në këtë sektor. Për të mbështetur shifrat e mësipërme, referuar "Regjis-

sektorit bujqësor dhe blegtoral. "Scan Intel" për ta pasqyruar sa më saktë pjesëmarrjen dhe aktivitetin e grave në sektorin e bujqësisë ka analizuar gjithashtu diplomimet sipas fushave dhe sipas gjinisë për vitin 2020. Shifrat sinjalizojnë se 2.3% e grave, përgjatë vitit 2020 janë diplomuar në fushën "Bujqësi, pyje, peshkim dhe

Përdorimi i pesticideve, KLSH: Mungojnë trupat kontrolluese, ngërç për sigurinë ushqimore

Përdorimi i Produkteve të Mbrojtjes së Bimëve (PMB) ku bëjnë pjesë edhe pesticidet është një terren i pa monitoruar siç duhet nga institucionet publike duke lënë kështu shkak për abuzime dhe cenim

nuk është bërë plotësimi i të gjithë numrave të nevojshëm të trupave kontrolluese dhe monitoruese. Mospërdorimi i produkteve që mbrojnë bimët është i demshëm ashtu sikurse është

turore të cilat nuk i kanë shërbyer plotësisht rritjes së efektivitetit të menaxhimit të PMB-ve dhe sigurisë ushqimore.

"Për të qenë më efektive dhe eficientë, ristrukturimet duhet të shoqërohen me rritjen e numrit të stafit profesional, duke respektuar kriteret sipas formimit, profesioneve në fushën e bujqësisë, trajnimet dhe testimet e tyre, sidomos të strukturat për mbrojtjen e bimëve në gjithë zinxhirin e menaxhimit të PMB-ve, por edhe të kapaciteteve administrative. Ndryshimet në strukturat administrative të institucioneve të MBZHR-së nuk janë kryer bazuar në, nevojat, kompleksitetin, kriteret të qarta vlerësuese, politikat për një menaxhim më të mirë të PMB-ve, si dhe praktikat më të mira. Pra kjo tregon një mosefektivitet të ndryshimeve të shpeshta strukturore në realizimin e qëllimit të menaxhimit të PMB-



të sigurisë ushqimore sipas një auditimi të Kontrollit të Lartë të Shtetit.

Ky i fundit vlerëson se stafet profesionale pësojnë ndryshim të shpeshtë në institucionet respektive ndërkohë që kanë nevojë për trajnime të vazhdueshme. Mbi të gjitha

përdorimi i tyre jashtë parametrave të nevojshëm, në periudha jo të përshtatshme apo në cilësinë e kërkuar.

Së pari Kontrolli i Lartë i Shtetit vlerëson se në Ministrinë e Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural para dhe gjatë periudhës objekt auditimi janë kryer reforma struk-

(Vijon në faqen 5)

Kompanitë japoneze, interes për investime në energjetikë, bujqësi dhe sigurinë e informacionit

Drejtori i Agjencisë për Zhvillimin e Investimeve (AIDA), priti në takim am-

basadorin e Republikës së Japonisë në Shqipëri, Takada Mitsuyuki.

Në takim u diskutuan aktivitetet që do të mbahen në kuadër të kremtimit të 100-vjetorit të marrëdhënieve diplomatike Japoni-Shqipëri.

Ambasadori Mitsuyuki, prezantoi gjithashtu edhe interesin e shprehur nga kompanitë japoneze që duan të bëjnë biznes në Shqipëri në sektorin e energjetikës, bujqësisë dhe sigurisë së informacionit.

Një pikë tjetër e rëndësishme e diskutimit, sipas AIDA-s, ishte dhe pjesëmarrja e Shqipërisë në panairin ndërkombëtar Expo Osaka 2025.



Barrierat për industrinë e vajit të ullirit - Subashi: Kostot shtesë do të reflektohen në çmime më të larta!

Industria e vajit të ullirit ka kapacitete të mjaftueshme për t'u rritur nëse të 12 milionë rrënjët e ullinjve do të futeshin në prodhim.

Në një intervistë për SCAN TV, ekspertja e fushës Silvana Subashi, shprehet se aktualisht prodhon vetëm gjysma e ullinjve dhe kjo ndodh për shkak të një sërë faktorësh.

Kriza e çmimeve orientoi konsumatorët drejt këtij produkti, duke e bërë më të kërkuar, çka tregon se edhe vëmendja për zgjerimin e këtij sektori duhet të jetë më e shtuar.

Por cilat janë pengesat e tjera që has industria? Rritja e kostove

dhe kryesisht energjia elektrike dhe nafta, pritet të sjellin rritje

të sjellë dhe rënie të kërkesës. Vendi ynë prodhon afro



të çmimit mbi konsumatorët sezonin e ardhshëm. Gjë që mund

100 mijë ton ullinj në vit dhe afro 20 mijë ton vaj ulliri.

Rama: Në fshatin Kurdari të Klosit, tjetër bujtinë e rrjetit të ri agroturistik

Në fshatin Kurdari të Klosit, mes malit dhe liqeneve Balgjaj, është ndërtuar bujtina "Çeliku".

Kryeministri Edi Rama publikoi sot pamjet nga kjo bujtinë, duke u shprehur se, "familja Çeliku me përkrahjen e qeverisë përmes programeve të AZHBR, po zhvillon vreshtarinë, arrat si dhe serat me produkte bio".

"Në fshatin Kurdari të Klosit, mes malit dhe liqeneve Balgjaj, është ndërtuar një tjetër bujtinë e rrjetit të ri agroturistik të Shqipërisë, ku familja Çeliku me përkrahjen e qeverisë përmes programeve të AZHBR-së, po zhvillon vreshtarinë, arrat si dhe serat me produkte bio, prej nga ku gatohen edhe ushqimet e

menusë së bujtinës "Çeliku", theksoi Rama.

"Lumi Mat, Kepi i Skën-

zona, e bëjnë qëndrimin me familjen e shoqërinë në këtë bujtinë një ripërtëritje të



derbeut, Ura e Vashës e shumë atraksione të tjera që ofron

vërtetë për trupin e mendjen", shtoi më tej kreu i qeverisë.

Prodhuesit e qumështit synojnë eksporte drejt vendeve të CEFTA-s

(Vijon nga faqja 2)

që janë të nevojshme për qasje në këto tregje, drejt krijimit të zonave rajonale ekonomike.

Sipas tyre rritja e standardeve të cilësisë dhe sigurisë ushqimore është faktor kryesor në nxitjen e eksporteve.

CEFTA është marrëveshje e Evropës Qendrore për Tregti të Lirë, të cilën e kanë nënshkruar

dhe ratifikuar shumë shtete si Kroacia, Shqipëria, Kosova, Mali i Zi, Maqedonia e Veriut, Serbia, Bosnje-Hercegovina dhe Moldavia.

Përmes programit IPARD, në sektorin e qumështit janë mbështetur 66 investime të reja në asete fizike në 26 bashki të vendit, ku 15 prej tyre janë startup.

Investimet e reja në industrinë e qumështit, kanë shtuar krahas prodhimit edhe numrin e vendeve të reja të punës.

Rreth 2000 vende të reja pune janë hapur, në të gjithë ciklin nga prodhimi i qumështit, te blegtoria në ferma moderne, ndërkohë që prodhimi i qumështit në vend siguron 99% të nevojave të tregut vendas.

IPARD III

Rama: 146 milionë euro nga programi IPARD 3, moment i rëndësishëm drejt rilindjes së Bujqësisë

Kryeministri Edi Rama deklaroi se financimi me 146 milionë euro për zhvillimin e bujqësisë dhe zonave rurale shqiptare nga BE përmes programit IPARD 3 është një moment mjaft i rëndësishëm në rrugën e rilindjes së bujqësisë.

Në fjalën e tij gjatë prezantimit të programit IPARD 3 në Shqipëri që do të financojë 146 milionë euro për zhvillimin

leadershipin e Fridës AZHBR u kthye nga problemi në zgjidhjen për shumë çështje të mprehta të sektorit, ku deri kur ne morëm detyrën pikat e grumbullimit numëroheshin me gishtat e dorës. Për të mos folur për standardet të cilat garantoreshin me përpjekje të mëdha me aq sa ishin mundësitë nga grumbulluesit. Dhe ndërkohë agropëpunimi ishte në belbëzim me

vestohen kursimet e punës në emigracion dhe të fitohet 2-fish, 3-fish, 5-fish më shumë sesa fitohet nga puna në emigracion. Sepse dihet botërisht që turizmi është eksport. Dhe nuk është ofruesi i shërbimit apo i produktit që shkon tek konsumatori, por është konsumatori që vjen tek ofruesi i shërbimit dhe kërkon produktin”, u shpreh Rama.

“Sot realiteti i agroturizmit, i cili është ende në një fazë të parë flet vetë. Realiteti i një numri të konsiderueshëm në raport me numrin zero që kishim kur e nisëm këtë punë, familjesh të cilat bëjnë sukses. Flet vetë edhe kjo situatë këtu ku jemi jo rastësisht të mbledhur, sepse ja çfarë është bërë në një zonë ku ka prodhim, në një zonë ku ka njerëz të punës, në një zonë ku ka fermerë të cilët gdhien dhe ngrysen duke u kujdesur për tokën, por ku deri dje kishte probleme nga fillimi deri në fund për të arritur për të marrë mbrapsht nga gjithë djersa e kulluar mbi tokën vlerën e arsyeshme të punës”, u shpreh Rama.

“Sot nuk është më fermeri që duhet të dalë në rrugë dhe të shesë prodhimet. Sot është grumbulluesi këtu që 500-600 fermerë në këtë rast i ka kontraktuar me marrëveshje për t'u marrë prodhimin dhe për t'u kujdesur ai për shitjen. Ndërkohë që fermerët punojnë të qetë se e kanë prodhimin e tyre të shitur pararakisht”, theksoi Rama.

“Flet shumëkush për bujqësinë që po vdes, për bujqësinë që s'merr dot më frymë. Për bujqësinë që nuk ka më asnjë perspektivë. Për fshatin që po braktiset përfundimisht dhe s'ka kush të punojë tokën. Dhe flasin njerëz që me fshatin s'kanë asnjë lidhje, ose njerëz që mund të jenë të lidhur me fshatin por nuk duan të kuptojnë se rruga e bërjes sukses ka ndryshuar tërësisht. Nuk është më rruga e vjetër e të punuarit vetëm, e të dalit vetëm në treg dhe e të fituarit vetëm. Nuk funksionon më, duhet bashkim forcash, ku secili ka pjesën e vet për atë pjesë të procesit që i takon atij. Jo bashkim forcash si dikur, por bashkim forcash, ku tjetërkush e punon tokën, tjetërkush e ofron farën dhe fidanin dhe mënyrën si trajtohet. Tjetërkush e bën grumbullimin dhe pastaj të gjithë bashkë bëjnë shitjen”, tha Rama.

Krifca: IPARD injektoi kapital në bujqësi, rritje të prodhimit dhe të cilësisë

Ministrja e Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural, Frida Krifca njoftoi çeljen e programit IPARD III financiar nga BE dhe qeveria shqiptare me buxhetin më të madh të dhënë për bujqësinë, në vlerën e 146 milionë eurove.

Në fjalën e saj, Krifca theksoi se, “në fund të vitit 2018 ne çelëm IPARD II duke i dhënë bujqësisë një hov zhvillimi si asnjëherë më parë”.

“Nëpërmjet këtij programi kemi mundësuar 67 ha serra të reja, 73 qendra grumbullimi, 132 traktorë dhe mjete bujqësore, 52 investime në bujtina të reja, 100 ha ferma bujqësore dhe blegtorale duke përafuar kështu standardet me BE në këtë sektor dhe angazhuar në punë një numër të konsiderueshëm njerëzish”, u shpreh ministrja.

Sipas saj, “40% e përfituesve nga ky program kanë qenë startup-e në bujqësi dhe sot pas 4 viteve implementimi të këtij programi kemi injektuar kapital financiar dhe kemi sjellë rritje të prodhimit dhe cilësisë, ku eksportet janë rritur 40%”.

“Sot ndajmë me ju lajmin që BE ka rritur buxhetin në mbështetje të bujqësisë përmes programit IPARD III, me një buxhet që shkon në 112 milionë euro nga BE. Shkojmë 56% më shumë buxhet se programi IPARDII. Ndërkohë financimi i qeverisë shqiptare 34 milionë

euro e çon këtë program në 146 milionë euro në mbështetje të bujqësisë dhe zhvillimit rural”, deklaroi Krifca.

Ministrja tha se, bashkë me financimin e fermerëve i gjithë injektimi i programit shkon në

meve në fermë, agropëpunim, diversifikim të fermës dhe asistencë teknike do të financojë dhe 5 masa të reja të cilat ndihmojnë Shqipërinë të përmbushë angazhimin e marrë në deklaratën e Sofjes për Axhendën e Gjelbër



225 milionë euro.

Ministrja e Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural Frida Krifca tha se në programin IPARD III po ecet drejt akreditimit për 9 masa financimi duke e zhvilluar më tej këtë program në përputhje me objektivat e qeverisë për zhvillimin e një bujqësie të qëndrueshme dhe të përafuar me politikat e Bashkimit Evropian duke e bërë kështu Shqipërinë ndër pak vende në rajon që adoptojnë 9 masa financimi për këtë program.

Buxheti prej 146 milion Euro i IPARD III përpos katër masave ekzistuese të investi-

në Ballkanin Perëndimor.

Krifca u shpreh se këto masa ndihmojnë që bujqësia, blegtorja, peshkimi, akuakultura dhe zhvillimi rural të mund të zhvillohen në një mënyrë të qëndrueshme duke respektuar natyrën nëpërmjet integritetit të masave agromjedisore, mbrojtjes së pyjeve dhe ruajtjes së mjedisit, zhvillimit të bujqësisë organike.

Për herë të parë përmes IPARD do të mund të zbatohet qasja Leader, një program që ka transformuar zhvillimin rural në vendet e Bashkimit Evropian.



e bujqësisë dhe zonave rurale shqiptare, Rama u shpreh se, “është një moment mjaft i rëndësishëm në rrugën e rilindjes së bujqësisë, aprovimi i një tjetër shume të konsiderueshme financimi nga BE për Shqipërinë, shumë e cila është më shumë se 50% më e lartë sesa shumata e financimit për pjesën që së bashku kemi mundur të vëmë në punë”.

“Me këtë financim të tretë masiv të BE-së hapet një rrugë edhe më e gjerë për të gjithë ata që do të ndjekin shembullin tuaj fantastik dhe natyrisht për të gjithë ju që do të doni të zhvilloni më tutje sipërmarrjen tuaj”, theksoi Rama.

“Kjo që po ndodh është një risi e jashtëzakonshme në jetën rurale të vendit tonë, e cila u vonua në fakt për shumë e shumë vite. Dhe unë dua këtu të bëj një vlerësim të veçantë për Fridën e cila i vlerësoi të gjithë të tjerët me të drejtë, kështu që më takon të bëj këtë vlerësim jo formalisht, por sepse është merita e saj që e transformoi AZHBR-në në një makineri të vërtetë financimi përmes arrijtes së akreditimit të Agjencisë nga BE që ishte pjesa më e vështirë”, tha Rama.

“Dhe fakti është që nën

disa realitete sporadike tek-tuk por gjithnjë me njerëz të punës që ishin totalisht të braktisur nga shteti”, u shpreh Rama.

Sot, theksoi kreu i qeverisë, “realiteti është krejt ndryshe, jo në sensin që ne jemi aty ku duhet të jemi, por në sensin që është hapur rruga e duhur tani për të gjithë ata që duan të vrapojnë më shpejt”.

“Ju jeni ndër ata që kanë vrapuar më shpejt dhe për këtë arsye përfaqësoni këtu realitete të prekshme të një transformimi konkret. Dhe jeni shembulli për fjalët që themi ne, lidhur me sesi mund të bëhet sukses në bujqësi nuk janë dëshira po janë fjalë që kanë mbështetje në fakte. Kur ne flasin për potencialin e agroturizmit nuk është më një e folur që bazohet me çfarë kemi menduar duke bërë analizat tona. As një e folur që bazohet sesi dëshirojmë ne që të jetë realiteti i njerëzve që kanë prona, kanë shtëpitë e gjyshërve të tyre në zona, ku është shumë e vështirë të krijosh kushte për një prodhim intensiv, apo në zona ku infrastruktura e bën tejet të kështueshme nxjerrjen e produktit në treg, ndërkohë që pikërisht aty mund të ndërtohet një sipërmarrje, e cila bën sukses”, theksoi Kryeministri Rama.

“Pikërisht aty mund të in-

Përdorimi i pesticideve, KLSH: Mungojnë trupat kontrolluese, ngërç për sigurinë ushqimore

(Vijon nga faqja 4)

ve” thuhet në dokument.

Duke u ndalur në shifra specifike auditimi i KLSH nënvizon se megjithëse Qeveria Shqiptare, në planin e buxhetit të MBZHR-së dhe institucioneve të varësisë që janë pjesë e detyrimit ligjor për kontrollin, monitorimin e tregtimit dhe përdorimit të PMBve, për tre vitet 2018-2020 i ka mbështetur me fonde dhe numër punonjësish, nga institucionet e mësipërme nuk është bërë plotësimi i duhur

i trupave kontrolluese e monitoruese respektivisht: viti 2018 me 21 punonjës më pak, krahasuar me planifikimin, viti 2019 me 36 punonjës më pak, krahasuar me planifikimin dhe viti 2020 me 27 punonjës më pak, krahasuar me planifikimin.

“Kjo tregon paaftësi menaxhuese të burimeve njerëzore dhe mungesë planifikimi të pabazuar në nevojat objektive në përmbushjen e detyrimeve ligjore” thuhet në auditim.

Po kështu i njëjti vlerëson se siguria ushqimore edhe pse ka

rëndësi të madhe kur vjen puna tek kontrolli i përdoruesve të mbrojtjes së bimëve trajtohet si diçka me rëndësi jo të lartë.

“Mungesa e dhënies së rëndësishme që ka siguria ushqimore dhe kontrolli i zinxhirit të tregtimit dhe përdorimit të PMB-ve, ka sjellë si pasojë, që ky proces të lihet në aspektin dytësor e tretësor të politikë bërjes së MBZHR dhe mos të kemi financime me program investimesh afat shkurtër dhe afatgjatë” vlerëson KLSH.

Implementimi i IPARD-it në Shqipëri, Bolleno: Modeli i suksesit në nivel rajoni

Takimi i 8-të i Komitetit Monitorues të programit IP-

ARDII, duke vlerësuar punën e kujtdo që ka qenë pjesë e

deri tek vetë fermerët dhe agrobizneset.



ARD-II, u zhvillua ditë e fundit në Tiranë, ku u diskutuan arrijtet dhe vështirësitë e implementimit të fondeve IPARD në Shqipëri.

Delegacioni nga Drejtoria e Përgjithshme e Bujqësisë të Bashkimit Evropian, ishte e përfaqësuar nga drejtori i saj Frank Bollen dhe Razvan Ghitescu, menaxher i programit për Zhvillimin Rural në Delegacionin Evropian në Shqipëri.

Ministrja e Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural Frida Krifca, në fjalën e mbajtur në këtë takim theksoi angazhimin e madh të autoriteteve dhe trupave që veprojnë në fushën e programit



procese, nga formulimi i programit, shqyrtimit të dosjeve, kontrollit në terren dhe disburimit të subjekteve përfitues, e

së shpejti do të implementohet nga AZHBR dhe u premtua për hapjen e thirrjes së parë në fund të vitit 2022.

FED INVEST

Qeveria shqiptare me mbështetjen e Japonisë dhe FED invest, synon zgjerimin e financimit dhe digjitalizimin e sektorit rural

Qeveria shqiptare në bashkëpunim me JICA (Agjencia Japoneze për Bashkëpunim Ndërkombëtar) dhe FED invest kanë punuar për më shumë se 4 vite, për përfshirjen financiare të fermerëve dhe sipërmarrësve të vegjël.

Palët zbatuese të Projektit "Përfshirja Financiare e Familjeve të Vogla", mbështetur nga Japonia, u mbledhën sot në një takim në Tiranë për të ndarë arritjet e përbashkëta në lidhje me përfshirjen financiare të sipërmarrësve të vegjël shqiptarë, ku merrnin pjesë ministria e Financave dhe Ekonomisë, Delina Ibrahimaj, ambasadori i Japonisë në Shqipëri, Takada Mitsuyuki, kryepërfaqësuesi i Zyrës së JICA për Ballkanin, Ueki Masahiro, si dhe zyrtarë të ndryshëm qeveritarë dhe të ftuar të tjerë.

Ministria Ibrahimaj, në fjalën e saj, vlerësoi punën e zhvilluar në këto vite për zbatimin e këtij projekti që ka rezultuar i

Financiare të Familjeve të Vogla" në Shqipëri.

Takada vuri në dukje se një

Banking online në gamën e plotë të shërbimeve, si llogari rrjedhëse, pagesa online dhe



nga shtyllat kryesore të politikës së Japonisë për zhvillim, është rritja e sigurisë njerëzore, duke fuqizuar individët dhe

transaksione të tjera të kryera në distancë;

Teknologji e avancuar për menaxhimin e proceseve që lidhen me dhënien e shpejtë dhe pa probleme të kredive për përfituesit në zonat rurale;

Shërbime jofinanciare për ata që kanë nevojë, nëpërmjet teknologjisë më të përditësuar të informacionit dhe komunikimit

Një qasje moderne dhe bashkëkohore për të adresuar problemet dhe vështirësitë e një pjese të rëndësishme të shoqërisë e cila deri më tani ka qenë e privuar nga ky lloj zhvillimi", tha ai

Zana Konini drejtoreshë e projektit FIAS: FEDInvest do të vazhdojë të mbështetë financimin e fermave të vogla familjare

Zana Konini, drejtoreshë e projektit FIAS, në fjalën e saj vuri në dukje se përfshirja financiare po merr vëmendje të

tarit në qendër. Nëpërmjet Qendrës ABA, 62 degëve të saj dhe kanaleve digjitale, FED invest është gjithmonë pranë anëtarëve të saj, në të gjithë Shqipërinë.

"Ky aktivitet, vijoi ajo, ka filluar si Projekt i Bankës Botërore dhe për mbi 30 vjet është transformuar, rritur ndjeshëm dhe është bërë një kontribues kryesor në financat sociale dhe rurale, duke mbështetur zhvillimin ekonomik të Shqipërisë. Sot FED invest përfaqëson një kooperativë financiare të konsoliduar, me mbi 82 mijë anëtarë dhe pasuri totale prej 7 miliardë Lekë.

"Projektin ynë FIAS filloi në shkurt të viti 2018 si një projekt i përbashkët midis Ministrisë së Financave dhe Ekonomisë, JICA-s dhe FED invest-it, duke synuar përmirësimin e përfshirjes financiare për fermerat e vogla në Shqipëri.

Në fund të këtij projekti, ne jemi krenarë për arritjet e prekshme nga aktivitetet e projektit, të cilat u zhvilluan nën një situatë të vështirë të pandemisë. Rezultatet janë shumëplanëshe, duke përfshirë, por jo vetëm: rritjen e përdorimit të produkteve dhe shërbimeve, përmirësimin e cilësisë së shërbimit, zgjerimin dhe digjitalizimin e ofertave për anëtarët, Qendrën ABA, edukimin financiar, etj", deklaroi Konini.

Ajo tha se, sot arritjet janë të rëndësishme, të prekshme, të mirëpritura dhe me impakt për fermerat e vogla familjare.

"Arritjet i dedikohen mbështetjes së vyer nga qeveria Shqiptare dhe JICA, si dhe angazhimit serioz të FED invest-it. Këto arritje përbëjnë një bazë

vazhdojë të mbështetët në këto iniciativa, sepse:

FED është një kooperativë financiare në pronësi të fermerëve; Shërbimet e FED invest dhe sidomos të ABA-s janë të hapura për të gjithë fermerët në shkallë kombëtare;

FED ka një shtrirje të gjerë dhe unike në zonën rurale, me zyra dhe network,

Përfaqësuesi i Agjencisë Japoneze të Bashkëpunimit Ndërkombëtar (JICA), Ueki Masahiro u shpreh se është një kënaqësi e veçantë, të pranojmë sot se së bashku me qeverinë e Shqipërisë, kemi realizuar me sukses zgjerimin e shërbimeve financiare të FED invest, duke rinovuar Sistemin e tyre Bankar (CBS), si dhe pajisjen me teknologjinë e informacionit të cilat tashmë mund të ofrojnë akses finan-

cial, me një sërë produktesh dhe shërbimesh, si shërbime pagesash, çeqe, mobile banking, për ata individë dhe grupe sociale që deri vonë nuk kanë përfituar këto shërbime.

Njohuri të kufizuara për teknologjitë dhe menaxhimin financiar

Pothuajse asnjë bashkëpunim mes fermerëve për të bashkuar përpjekjet dhe për të ndarë njohuritë dhe burimet dhe për të kombinuar disa aktivitete për prodhim, paketim dhe shitje, duke ulur kështu kostot dhe për të rritur shitjet.

Ndikuar seriozisht nga lufta në Ukrainë me rritje të konsiderueshme të çmimeve të inputeve

Penetrim ende shumë i ulët me llogaritë rrjedhëse dhe shërbimet e pagesave

Edukim i ulët financiar dhe digjital

Pse FED invest mund të luajë një rol të rëndësishëm në përfshirjen financiare në zonat rurale

30 vjet përvojë pune në zonat rurale;

Prezent në komunitetet rurale me staf vendor me përvojë;

Qeverisje unike me anëtarin në qendër dhe drejtim social;

Licencuar së fundmi për të ofruar të gjitha llojet e shërbimeve të pagesave;

Me mbështetjen e JICA, FED invest ka krijuar një infrastrukturë të re harduer dhe softuer dhe ka zhvilluar shërbime të reja financiare dhe jo financiare;

Çmime konkurruese për kreditë dhe produktet e depozitave;

62 degë dhe 300 punonjës, me më shumë se 50% gra;

62 degë dhe 300 punonjës, me më shumë se 50% gra;

62 degë dhe 300 punonjës, me më shumë se 50% gra;

62 degë dhe 300 punonjës, me më shumë se 50% gra;

62 degë dhe 300 punonjës, me më shumë se 50% gra;

62 degë dhe 300 punonjës, me më shumë se 50% gra;

62 degë dhe 300 punonjës, me më shumë se 50% gra;

62 degë dhe 300 punonjës, me më shumë se 50% gra;

62 degë dhe 300 punonjës, me më shumë se 50% gra;

62 degë dhe 300 punonjës, me më shumë se 50% gra;



suksesshëm falë bashkëpunimit të shkëlqyer të Ministrisë së Financave dhe Ekonomisë, JICA dhe FED Invest.

"Nëpërmjet Projektit FIAS është bërë i mundur përmirësimi i përfshirjes financiare të ekonomive dhe fermave familjare në zonat rurale në Shqipëri. Një arritje shumë e rëndësishme e këtij projekti, është krijimi i një qendre Agro Biznesi e ngritur në Lushnje (Qendra ABA) nëpërmjet të cilës synohet përbushja e nevojave të çdo fermeri shqiptar me qëllim zhvillimin e fermave familjare në zonat rurale në Shqipëri, zhvillimin e biznesit dhe ndërtimin e kapaciteteve dhe aftësive financiare", tha Ibrahimaj.

Ibrahimaj theksoi se një nga nismat e Qeverisë është "Revolucioni Digjital, për lehtësimin e qytetarit nga pengesat në marrjen e shërbimeve. "Qendra ABA është një shembull që përkon me nismën e Qeverisë për Revolucionin Digjital, ndaj shpresoj që sukcesi i nisur i këtij projekti dhe bashkëpunimi të shkëlqyer të shikohet nga Qeveria Japoneze si një mundësi për të vijuar më tej këtë bashkëpunim drejt zhvillimit të përfshirjes financiare, aksesit në financë, edukimit financiar dhe digjital".

Ambasadori i Japonisë në Shqipëri, Takada Mitsuyuki, gjatë fjalës së tij, tha se sot jemi këtu për të festuar si skuader, punën e palodhshme të bërë në një periudhë më shumë se 4 vite e gjysmë, të ekspertëve japonezë dhe shqiptarë për "Përfshirjen

komunitetet, përpjekje të cilën a materializojmë në Shqipëri përmes këtij projekti për rritjen e aksesit në financa për ata që nuk e kanë pasur këtë mundësi më parë, si Banking online në gamën e plotë të shërbimeve, si llogari rrjedhëse, Teknologji e avancuar për menaxhimin e proceseve që lidhen me dhënien e shpejtë dhe pa probleme të kredive për përfituesit në zonat rurale.

"Kjo konferencë po zhvillohet në vitin që shënon 100-vjetorin e marrëdhënies miqësore mes Shqipërisë dhe Japonisë. Jam shumë i kenaqur që vijmë në këtë 100-vjetor me arritje dhe suksese të tilla", tha ai

"Megjithatë, kjo sipërmarrje serioze është vetëm fillimi i një rrugë të gjatë dhe sfiduese për arritjen e zhvillimit të qëndrueshëm të familjes së pronarëve të vegjël në zonat bujqësore dhe rurale. Pala japoneze mbetet e hapur, për të kontribuar më tej në konsolidimin arritjeve dhe zgjerimin e gamës së shërbimeve që do të sjellin zhvillimin e mëtejshëm bujqësor dhe rural të vendit, nëse një gjë e tillë do të jetë në dëshirën dhe konsideratën e autoriteteve shqiptare" deklaroi ambasadori.

Takada Mitsuyuki, Ambasadori i Japonisë në Shqipëri, u shpreh: "Arritjet e këtij projekti janë shumëdimensionale dhe me pamje të qarta:

Akses në financa për ata që janë më të cënueshëm dhe nuk e kanë pasur këtë mundësi më parë;



madhe në axhendat qeveritare të pothuajse çdo vendi.

"Covid 19 përshpejtoi risinë dhe prirjet teknologjike për të arritur tek klientët dhe pronarët e vegjël nëpërmjet kanaleve dhe produkteve alternative, duke konkurruar me ato tradicionale. Qeveria e Shqipërisë ka nisur kohët e fundit një proces të digjitalizimit të shërbimit publik, i cili do të ketë efekte të mëdha në jetën tonë të përditshme dhe aksesin në finance", tha Konini, teksa vuri në dukje se, në këtë frymë lindi dhe u zbatua projekti FIAS.

Konini theksoi se, FED invest modeloi identitetin e vet përgjatë 30 viteve përvojë, bazuar në filozofinë e saj të anë-

të shëndoshë, por që kërkon akoma zhvillim dhe konsolidim", u shpreh Konini.

Ajo shprehu bindjen se, FED invest i vendosur të rrisë dhe zgjerojë përfshirjen financiare dhe fuqizimin e Qendrës ABA, bazohet në: përvojën dhe instrumentet e zhvilluara në 30 vite dhe të strukturuar më tej gjatë projektit FIAS, nevojat dhe kërkesat në rritje të fermerëve nga të cilët mbi 90% janë fermerë të vegjël.

Thellimi i bashkëpunimit me partnerë strategjikë është vital për mbarëvajtjen e këtyre nismave

Ne besojmë se FED do të

KËNDI I EKSPERTIT

Këshilla për mbrojtjen e bimëve

(Proгноza e parazitëve kryesorë për periudhën, 11-20 Maj, 2022)

Përgatiti Prof. Ass. Enver ISUFI
Instituti i Bujqësisë Biologjike, Durrës

(ibb, Durrës), (facebook enver isufi), (en.isufi@gmail.com)
Mund ta gjeni edhe në blogun "Bota Bujqësore"

Edhe dhjetëditori i dytë i muajit maj është ndër periudhat delikate për mbrojtjen e bimëve. Gati të gjithë parazitët do jenë në aktivitet biologjik. Ky dhjetëditor u shoqërua me temperaturë të ulëta. Në këto kushte moti u frenuan shvillimet e sëmundjeve dhe disa insekteve.

Nëse marrim masat mbrojtëse në kohën e duhur



dhe kur është e nevojshme, mund të kursejmë punë dhe bazë materiale në periudhën që vjen; e kundërta, nëse do kemi infeksione që në fillim të periudhës bimë, na duhet punë dhe investime shtesë për të mbrojtur bimët nga parazitët kryesorë.

HARDHIA:

Si në dhjetëditorin e parë, në hardhi Hiri edhe Vrugu do jenë sëmundjet kryesore. Trajtimet kundra të dyja sëmundjeve bashkëshoqërohen me fungici-

det përkatëse. Aty ku nuk kemi shenja të sëmundjeve, përdoren produktet me veti kontakti, aty ku kemi shenja të shfaqjes sëmundjeve, përdoren produkte me veti sistemi (dmth, produkte që qarkullojnë me sistemin e qarkullimit të limfës, e cila merr me vete edhe fungicidin deri atje ku është infeksioni kërpuhës)

Për tenjën e hardhisë (Lobesia botrana) nuk duhet shqetësuar shumë. Nëse tolerohet breznia e parë në trajtime, do ishte më mirë. Pse? -sepse

tenja do hajë ato lule, të cilat do binin vetë dhe do të mbeten gjithmonë mjaftueshëm lule për të realizuar prodhimin. Nëse përdoren feromonet çorientuese si ISAMAT L, dispensërat e këtij produkti mund të varen edhe gjatë dhjetëditorit të dytë të muajit maj. Me këtë produkt, nuk lind nevoja për trajtime të tjera në vreshtë për të gjithë sezonin. Këtë produkt fermerët tanë biologjikë, kanë vite që e përdorin në vreshtat e tyre dhe tashmë kanë fituar siguri dhe nuk kanë shpenzuar me trajtime të tjera me insekticide të zakonshme.

Krasitjet e blerta dhe largimi i barërave të egra janë kushte shtesë që pengojnë infeksionet e larta. Këtë kohë kur bimësia zhvillohet shpejt, duhet që krasitjet e blerta dhe pastrimi i barërave të egra nuk duhen nënvlerësuar.

ULLISHTE

Nuk do të ketë ndonjë urgjence fitosanitare. Në kultivarët më të prekshëm nga

syri i palloit në gjethe, mund të përsëriten trajtimet me produkte me bazë bakri (tek Kalinjoti, Kokërmadhi Beratit, Belo di Spanjë e ndonjë tjetër.) Grupi i kultivarëve kokërrvogël, i grupit të Frantojt, janë më të qëndrueshëm nga syri i palloit) Shënim. Për Pleshtin e ullirit do t'ju bashkëngjisim një artikull të plotë.

MOLLA

Në zonën E ULËT DHE BREGDETARE, vazhdojnë trajtimet për sëmundjen e kromës dhe të hirit në ato pak kultivarë që janë të ndjeshëm ndaj hirit. Në kultivarët e qëndrueshëm kundra kromës trajtimet mund të bëhen në largësi ditësh edhe më të mëdha se tek kultivarët e prekshëm ndaj kromës. Duhet të bëhen kontrolle për të kapur infeksionet e para në kokërr nga krimbi i mollës.

Afidet trajtohen kur mbi 10 % e lastarëve janë me infeksion.

- Morri, i cili deformon frutat dhe gjethet, është më i

rezikshëm. Emri i tij është morri mjellor i mollës (Dysphid plantaginea). Kundër tij trajtohet kur 2-3 % e lastarëve ose degëve të reja kanë shenjë, pra koloni morrash në gjethe dhe lastare.

- Krimbi i mollës duhet pritur kur të ketë arritur maksimumi i fluturimit të fluturave në feromonet monitories, dhe ndërkohë të zbulohen pickimet e parë në lëkurën e frutave të rinj të shkaktuar nga larvat e para të krimbit të mollës.

- Në zonën VERIORE, VERI LINDORE, JUGLINDORE, trajtimet e para për mbrojtje nga kroma kanë filluar qysh në fazën kur gjethet kanë madhësinë e gjetheve të miut dhe janë përsëriur pas 10-12 ditëve.

Si orientohemi për trajtimet për kromën?

- Trajtimi i parë, fillon direkt pasi kemi kapur askosporet e para në sporakapës ose nga programi kompjuterik RIMPRO

- Trajtimet e tjera përsëriten

kur bie mbi 15 mm shi. Trajtimet mund të përsëriten qysh të nesërmen, nëse bien mbi 15 mm shi, sepse është shpallur shtresa e tretësirës spërkatjen mbi gjethe dhe frutat e mollës.

- Përsëritjen e trajtimeve e kërkon edhe fakti që filizat rriten shpejt dhe pjesët e reja të bimës, janë të pambulura me tretësirë spërkatëse nga trajtimi i mëparshëm.

- Krimbi i mollës (Cydia pomonella): ME DATËN 10 MAJ në zonën e Korçës (DVORAN) u kapën fluturat e para të krimbit të mollës në gratat e feromoneve monitoruese.

Ky sinjal është i mjaftueshëm për të varur në pemët e mollës feromonet çorientuese të çiftëzimit të fluturave. DISPENSËRAT E KËTJË PRODUKTI (ISONET L ose ISONET CTT), duhet të varen para se fluturat të çiftëzohen.

Këtë dhjetëditor kokrrat do të mbahen nën kontroll për infeksionet e reja, por besoj se nuk do të lindë nevoja për trajtime me insekticide. Nëse kapen larvat e para të krimbit mbi frutat e reja të mollës, do t'ju njoftojmë më një informacion të parakohshëm, për të filluar trajtimet me insekticide.

...Mbani gjithmonë kontakte me agronomët, qendrat e prognozë-sinjalizimit dhe me kolegët tuaj fermerë me me përvojë.

Ju urojmë një sezon të mbarë në prodhimet tuaja!

(Vijon nga faqja 6)

Ka krijuar tashmë një program për edukimin financiar dhe digjital;

Ndërton marrëdhënie të forta me partnerë strategjikë duke përfshirë RaboBank, EFSE, Fondin Evropian të Investimeve, të cilët kanë synime zhvillimi për të mbështetur fermerët, sipërmarrësit mikro dhe të vegjël;

FED invest synimet strategjike

FED invest ka caktuar synimet strategjike të mëposhtme:

FED invest do të vazhdojë të përmblushë rolin e saj të rëndësishëm drejt përfshirjes financiare të fermerëve dhe sipërmarrësve mikro në Shqipëri.

FED invest do të kërkojë të ofrojë një gamë të gjerë shërbimesh bankare në një mënyrë me kosto efektive për këto segmente dhe të plotësojë një boshllëk që është ende i rëndësishëm në sektorin financiar.

FED invest do të vazhdojë në vijimësi të ofrojë edukim financiar dhe shërbime jo financiare për fermerët, sipërmarrësit mikro dhe të vegjël me objektiv rritjen e njohurive dhe aftësive të tyre financiare dhe të biznesit.

Marka dhe imazhi i FED invest si një institucion "financimi social" do të forcohet më tej përmes fushatave të marketingut pro-aktiv, të larmishëm, përmes aktiviteteve ballë për ballë, komunikimit të drejtpërdrejtë dhe angazhimit në mediat sociale.

FED invest objektiva specifike për 4 vitet e ardhshme,

Qeveria shqiptare me mbështetjen e Japonisë dhe FED Invest, synon zgjerimin e financimit dhe digjitalizimin e sektorit rural

Sulja renditi:

Për 4 vitet e ardhshme FED invest do të vazhdojë të ruajë një rritje solide si për kreditë ashtu edhe për depozitat dhe do të rrisë aktivitetin e produkteve dhe shërbimeve të pagesave.

Portofoli i kredisë dhe i depozitave planifikohet të rritet me 12% nga viti në vit dhe të ruajë një cilësi të lartë të portofolit të kredisë. Në aktivitetin kreditues do të ketë fokus të veçantë në rritjen e segmentit të NVM-ve dhe zhvillimin e financimit të zinxhirit të vlerës, duke vijuar t'i ofrojë qasje në financa pronarëve të vegjël.

Ofrimi i një pakete të larmishme pagesash komunale për klientët urbanë dhe ruralë. Krahas pagesave për energjinë elektrike (tashmë të vendosura), do të nisë edhe pagesat për të gjitha shërbimet përmes një kontrate të drejtpërdrejtë me ofruesit ose me nënkontraktim.

Numri i anëtarëve me llogari rrjedhëse do të rritet ndjeshëm si një instrument për të siguruar transferime nga llogaria në llogari dhe për të arritur qasje në financa. Do të ofrohen shërbime transaksionesh cash-in dhe cash-out për degët kryesore dhe transfertat e pagesave në banka të tjera rezidente do t'u ofrohen anëtarëve të FED.

Promovimi i mëtejshëm i FED në internet do të vazhdojë për të siguruar shërbime digjitale për klientët në distancë dhe

ata me aftësi dhe mjete digjitale. Prezantimi i pagesave të tjera digjitale për një sërë kategorish të shitësve, duke përfshirë pagesat QR do të mundësohet gjatë viteve 2023-2024. Zgjidhjet e pagesës së remitancave nga emigrantët shqiptarë për të afërmit e tyre, veçanërisht banorët në zonat rurale do të ofro-



hen përmes degëve tona dhe në mënyrë digjitale.

Penetrimi në treg do të rritet përmes kanaleve digjitale dhe alternative dhe me zgjerimin me degë të reja në zona me potencial të lartë, 8 degë të tjera të planifikuara për 4 vitet e ardhshme.

Do të ruhet një ekuilibër i shëndetshëm i kapaciteteve dhe motivimit të stafit, investimeve në teknologji dhe performancës operacionale duke pasur parasysh rritjen e planifikuar të aktivitetit dhe shërbimeve.

Marrëdhëniet me partnerët strategjikë do të forcohen me objektivin e konsolidimit të pozicionit financiar dhe kontrolleve të brendshme.

Mundësi ndërshite për anëtarët e qendrës ABA që nuk janë anëtarë të FED.

Drejtori Ekzekutiv i FED invest vlerësoi Qendrën ABA

internet për produktet bujqësore për të integruar edhe opsionet e pagesave on-line", tha Sulaj ndër të tjera.

Përmes bashkëpunimit ndërmjet ekipit zbatues shqiptar dhe japonez, projekti ka kontribuar me sukses në përmirësimin e përfshirjes financiare të familjeve të vogla rurale në Shqipëri. Projekti e arriti këtë duke zhvilluar produkte të reja financiare dhe shërbime jo financiare që i përgjigjen në mënyrë fleksibile nevojave të fermerëve. Kjo është mundësuar duke forcuar kapacitetet e Shoqërisë së Kursim Kreditit, FED invest, për të ofruar shërbime financiare në zonat rurale të vendit. Fokusi i zhvillimit të kapaciteteve të Projektit përfshin një gamë të gjerë aktiviteteve, nga përmirësimi i kapacitetit të IT-së të FED invest deri të trajnimit i stafit bazuar në parimin klienti në qendër, si dhe ofrimi i edukimit financiar dhe digjital për fermerët.

Projekti ka qenë i dobishëm në zhvillimin e Qendrës ABA dhe platformës së saj digjitale ABA online, e cila i është përkushtuar ofrimit të informacionit jo-financiar dhe shërbimeve të nevojshme për fermerët e vegjël. Projekti gjithashtu ofroi mbështetje për blerjen e inputeve bujqësore nga fermerët e vegjël gjatë periudhës së pandemisë COVID-19 në mënyrë që të inkurajojë inves-

dhe platforma abonline.al një instrument për të rritur përfshirjen financiare

Më shumë se 10 mijë anëtarë të regjistruar në platformë, që kanë qasje në materialet e edukimit financiar dhe digjital, si dhe informacionin e produkteve financiare dhe aplikimin on-line;

Rritja e kapaciteteve dhe njohurive të fermerëve do të rezultojë në nevojën për më shumë shërbime financiare; "Do të zhvillohet funksionaliteti i shitjes dhe blerjes në

timet e tyre të vazhdueshme në bujqësi.

ABA online është 'shërbim jo financiar' i zhvilluar me mbështetjen e Projektit të JICA. FED invest është institucioni i parë mikro-financiar, pionier, i krijuar në Shqipëri në vitin 1992. Anëtarësia e FED invest përfshin fermerë, sipërmarrës të vegjël, familje rurale dhe periferi urbane të përjashtuara nga shërbimet financiare. FED invest mbulon të gjithë territorin e Shqipërisë, me 62 degë në gjithë vendin një prani e fortë rurale në më shumë se 2500 fshatra, tashmë e plotësuar me kanale digjitale dhe shërbime digjitale. Si lider në ofrimin e zgjidhjeve financiare të përballeshme për popullsinë rurale, FED invest ka një ndikim të drejtpërdrejtë në zhvillimin social-ekonomik të Shqipërisë, me mbi 200 mijë kredi dhe gjysmë miliardë euro të injektuara në ekonomi gjatë 30 viteve të ekzistencës së saj.

Ekonomia shqiptare bazohet në një segment të madh të bizneseve bujqësore dhe familjare dhe 45% e popullsisë banon në zonat rurale. Shkalla e përfshirjes financiare në Shqipëri është e ulët. Vetëm 38% e njerëzve mbi pesëmbëdhjetë vjeç kanë llogari bankare në institucionet financiare formale, duke lënë shumë familje pa llogari në këto institucione.

Projekti ka punuar në drejtim të përmirësimit të jetesës së 75 mijë fermerëve të vegjël përmes rritjes së kapacitetit të FED invest dhe përmirësimit të shërbimeve që u ofrohen atyre.



SHOQATAT ANËTARE

AVALB FEDINVEST BKFSH EKR IBMA HABA AOA UPM LEAA ADAMA ABA SHGF ALBAFLOR

SHKPVF RKUK SVP MSHKM BIOADRIA PPAM SHT UOTSH KEA BIOPANT ADAD PSN

KËSHILLAT RAJONALE

TIRANA DURRESI FIERI ELBASANI SHKODRA DIBRA

LEZHA GJIROKASTRA KORÇA BERATI VLORA KUKESI



Këshilli i Agrobiznesit Shqiptar

www.kashalbania.org

Këshilli i Agrobiznesit Shqiptar



KREDI PËR ÇDO SIPERMARRËS

KREDI E SHPEJTË ME NORMA KONKURRUESE

deri në
7 MILIONË
Lekë



FED
invest 


**GJITHMONË
FINANCË SOCIALE**

AKTUALITET

Ditët e bujqësisë 2022 dhe forumi i bujqësisë dhe agroturizmit

Andon Rrapokushi
Konsulent i Çertifikimit GlobalGAP

Për herë të parë, një panair i madh agrobiznesi me karakter kombëtar dhe ndërkom-bëtar nuk u zhvillua në Tiranë sipas traditës, por në një qytet tjetër. Dhe ky qytet, i cili njihet si epiqendra e bujqësisë shqiptare, ishte Lushnja. Madje për Lushnjën, e njohur si Hambari i Myzeqesë, janë vënë edhe epitete të tjera në raporte të donatorëve, si shporta e gjelbër e Shqipërisë (Green



Andon Rrapokushi

Basket of Albania), apo kryeqyteti i eksporteve bujqësore (siç shkruhej me të drejtë në website-in e organizatorëve, Iceberg Exhibition). Për më tepër shkolla e parë bujqësore në Shqipëri është krijuar në Lushnjë në vitin 1921.

Gjatë tre ditëve të tij, nga 19-21 maj 2022, labirinti i standeve të panairit ishte i përbërë nga mbi 60 subjekte, më së shumti private, por edhe publike (AKU, QTTB), kompani agrobiznesi, inputesh bujqësore, kompani konsulence dhe organizata të tjera, të cilat në standat e tyre shfaqën shërbimet dhe produktet që ato ofrojnë në fushat e bujqësisë, eksportit, blegtorisë, inovacionit, dixhitalizimit dhe agroturizmit, jo vetëm nga Shqipëria por dhe nga vende të tjera europiane.

Realizimi i kësaj ngjarjeje me të tilla përmasa jashtë Tiranës, u bë i mundur nga Iceberg Exhibitions si organizatori

kryesor, një kompani me eksperiencë mbi 20 vjeçare, e cila ka meritën për përzgjedhjen strategjike të vendit dhe për arritjen e një koordinimi harmonik ndërmjet aktorëve kryesorë për ta realizuar me sukses atë, siç janë Bashkia e Qytetit Lushnje, Ministria e Bujqësisë, Këshilli i Agrobiznesit Shqiptar, RisiAlbania, Vodafone Albania, Fed Invest dhe partnerë të tjerë të cilët morën pjesë në këtë panair.

Forum i Agrobiznesit dhe Agroturizmit me temë: "Bujqësia, Turizmi Rural dhe Mjedisi në Zonat Rurale në Shqipëri", i drejtuar dhe moderuar nga presidenti i KASH, z. Agim Rrapaj, në një nga sallat e kinoteatrit "Vaçe Zela", ishte aktiviteti kryesor i cili i dha kuptimin dhe forcoi karakterin profesional të Panairit, sepse aty u trajtuan hapur, në mënyrë objektive dhe larg ngjyrimeve partiake problemet më të rëndësishme aktuale të sektorëve të bujqësisë, agroturizmit dhe inovacionit dhe u hodhën ide dhe propozime për zgjidhjen e tyre me pjesëmarrjen dhe kontributin e ekspertëve dhe profesorëve të njohur të këtyre fushave, si edhe të përfaqësuesve të lartë të institucioneve qendrore dhe lokale nga Ministria e Bujqësisë, ajo e Turizmit, AKU, AZHBR, etj.

Prof. Rexhep Uka, në diskutimin e tij në Forum përmendi një radhë të gjatë emrash të shquar dhe të respektuar të bujqësisë shqiptare, duke theksuar se ajka dhe korifejtë e bujqësi shqiptare, Ali

Ypi, Mentor Përmeti, Skënder Gozhita, Hysen Çobani, Polo Çakalli, Sokrat Jani...kanë punuar me përkushtim, pasion dhe profesionalizëm të lartë në Lushnjë për vite me radhë dhe Lushnja u dha atyre lavdinë.

Shumë prej emrave të nderuar të cilët u përmendën në Forum, kanë punuar në Institutin e Kërkimeve Bujqësore (tani QTTB) në Lushnjë, duke dhënë një kontribut të çmuar në shkencën e bujqësisë shqiptare me studimet dhe kërkimet e tyre eksperimentale në fushën e bimëve të arave si edhe të perimeve. Do të ishte në nderin e këtij institucioni shkencor që të prezantonte gjithashtu në këtë Forum ekspertësh aktivitetin e QTTB Lushnje në ditët e sotme, gjë që nuk ndodhi, megjithëse ka për të treguar dhe bërë të njohur.

Stephan Joss, drejtor i projektit zvicerian në RisiAlbania, në fjalën e tij vlerësoi organizimin e këtij eventi në Lushnjë, si një qendër e madhe e bujqësisë shqiptare me potenciale të mëdha prodhimi dhe punësimi në sektorin e agrobiznesit dhe theksoi që RisiAlbania mbështet zhvillimin e konkureshmërisë dhe rritjen e cilësisë së prodhimit nëpërmjet proceseve të certifikimit GlobalGAP dhe organik, por gjithashtu Risi-a nxit dhe mbështet edhe nevojën për njerëz të kualifikuar në çdo sektor të bujqësisë: në prodhim, në përpunim, në marketing, në agromekanikë, në shërbime financiare, në dixhitalizimin e fermave etj.

Duke folur për problemin

e kooperimit të fermerëve dhe bashkimit e tyre në kooperativa marketingu, prof. Bahri Musabelliu theksoi nevojën për ndryshimin e ligjit për SHBB-të dhe dhënie konkrete të ndihmës nga shteti. Duke bërë një krahasim me kooperativat e sistemit komunist (dhe duke lënë mënjanë anën ideologjike), ai tha se qeveria e asaj kohe nuk e bëri më kot kooperativën e parë në Krutje të Myzeqesë, një vend potencial bujqësor, madje e stimuloi dhe e ndihmoi atë fuqishëm me të gjitha mjetet agroteknike dhe motorike për ta forcuar. Por SHBB-të sot përgjithësisht janë të dobëta, ato akoma nuk janë bërë një model nxitës kooperimi për fermerët e vegjël. Prandaj kanë nevojë për mbështetje nga shteti që të zhvillohen, nuk do t'i kushtonte ndonjë gjë e madhe shtetit sot theksoi prof. Musabelliu, nëse do të vinte në dispozicion të SHBB-ve një fond qoftë edhe të vogël psh 300,000-400,000 Euro, për t'i subvencionuar ato. (Disa vite më parë kishte një studim për këtë qëllim me mbështetjen e donatorëve të huaj, dhe specialistët e këtij projekti promovuan se paga e administratorit ose e financierit të çdo SHBB-je do të subvencionohej me 200 Euro/muaj, por në fakt nuk u bë gjë).

Në Forum u fol edhe për agroturizmin, duke theksuar se agroturizëm pa përmirësim të dukshëm të mjedisit nuk mund të ketë. Agroturizmi është një sektor që ofron shumë vlera dhe shërbime, redukton CO2, pasuron florën dhe faunën dhe

bujqësia peri-urbane në vendin tonë po zhvillohet me krijimin e fermave shumëfunktionale, të cilat janë në modë. Në lidhje me këtë temë, kryetarja e Bashkisë Lushnje, zj. Eriselda Sefa, tha: "Ndjem e keqardhur që në Lushnjë nuk ka akoma një agroturizëm, megjithëse ka shumë potenciale mjedisore, bujqësore dhe turistike, sidomos në zonën kodrinore".

Zv. Ministri i bujqësisë z. Dhimo Kote, duke shprehur dakordësinë me të gjitha sa u thanë në Forum, tha: "Pavarësisht problemeve që ka bujqësia, ka edhe arritje të cilat duhet t'i njohim dhe të mos nxijmë çdo gjë, puna e fermerit do respektuar", duke sjellë shembullin e njerit prej dy administratorëve të kompanisë Doni Fruits, z. Burim Ahmeti, i cili qysh kur ishte një djalë tepër i ri, jo më tepër se 18 vjeç, shkoi në Xarrë të Sarandës (kohë kur z. Kote ishte kryetar i asaj komune dhe e takoi për herë të parë Burimin) për të blerë mandarina dhe vit pas viti, gradualisht kompania Doni Fruits u rrit dhe sot është kthyer në një nga pikat më të mëdha të grumbullimit dhe eksportit të fruta-perimeve në Shqipëri dhe rajon, me një infrastrukturë moderne, e cila është edhe krenari kombëtare.

Theksojmë se Forumit të Lushnjës i kishte paraprirë tre javë më parë Tryeza Tematike e zhvilluar në Kompleksin Turistik UKA Farm në Laknas të Tiranës, produkt i të cilit ishte nxjerrja dhe përgatitja pas konsultimeve me shoqatat e KASH dhe aktorë të tjerë, e një Projekt

Rezolute për bujqësinë, turizmin rural dhe ruajtjen e mjedisit që doli si rezultat i problematikave të këtyre sektorëve të rëndësishëm, si sektorë jetikë për rolin dhe rëndësinë që kanë, për rritjen e të ardhurave të familjeve fermerëve, për punësimin gjithëvjetor të tyre dhe sigurimin e ushqimit, për rritjen e eksporteve dhe reduktimin e importit të produkteve ushqimore, si dhe për zhvillimin e qëndrueshëm të zonave rurale në tërësi.

Kjo projekt-rezolute ishte në qendër të Forumit të Lushnjës gjithashtu, një dokument 9 faqesh i cili, duke marrë në konsideratë problemet konkrete të prodhuesve, agroturizmit, banorëve të zonave rurale, përcakton objektiva të qarta dhe propozime konkrete për institucionet përkatëse, Ministrinë e Bujqësisë, Ministrinë e Turizmit, AKM (Agjensinë Kombëtare të Mjedisit), ISHMP etj., si edhe propozimi tjetër i KASH për përgatitjen dhe miratimin e një Pakete Ligjore të domosdoshme e cila përfshin ndryshime në disa ligje kryesore me qëllim reduktimin e kostove të prodhimit, lehtësimin e kooperimit ndërmjet prodhuesve dhe rritjen e efikasitetit të skemave mbështetëse.

Pasi mori mbështetjen e plotë nga të gjithë aktorët respektivë pjesëmarrës në Forum, mbetet për t'u parë realizimi i propozimeve të kësaj Rezolute nga agjensitë dhe strukturat përkatëse.

Rezoluta thekson gjithashtu se KASH angazhohet për ngritjen dhe funksionimin periodik të një Këshilli Konsultativ Kombëtar për Bujqësinë, Turizmin Rural dhe Mjedisin në zonat rurale, i aftë të formulojë dhe t'u propozojë institucioneve publike dhe private një paketë më të detajuar masash për zgjidhjen e problemeve.

Regulloret në BE dhe USA

Në verën e vitit 2020, Bashkimi Evropian (BE) uli ndjeshëm Nivelet Maksimale të Mbetjeve (the Maximum Residue Levels -MRLs) për



Prof. Alban Ibrahimi

klorpirifos dhe metil-klorpirifos deri në 0.01 mg/kg, për pjesën më të madhe të lëndëve të para bimore/bimë të papërpunuara (shih "rregulloren (BE) 2020/1085 der Komisioni vom 23 2020"). Praktikisht, bazuar në këtë rregullore kjo do të thotë zero tolerancë për çdo produkt të bimëve aromatike dhe mjeksësore që tregëtohen në BE.

Klorpirifosi dhe Klorpyrifos-metil dhe etil në lëndët e para me origjinë bimore

Ky informacioni nuk pretendohet të jetë i plotë. Ai synon të shërbejë si informacion me fokus në Konformitetin e lëndëve të para me origjinë bimore sipas rregulloreve dhe zhvillimeve të tregut

Në Gusht 2021, Agjencia Amerikane për Mbrojtjen e Mjedisit-EPA (the US Environmental Protection Agency -EPA) publikoi një rregull të ri, e cila përcakton gjithashtu zero tolerancë ndaj mbetjeve të klorpyrifos në ushqime, rregullore e ngjashme me rregulloret në Bashkimin Evropian. Bazuar në sa më sipër, çdo tolerancë për këtë kimikat edhe në SHBA ka përfunduar në shkurt 2022. Shih për më tepër linkun e mëposhtëm: <https://www.epa.gov/newsreleases/epa-takes-action-address-risk-chlorpyrifos-and-protect-childrens-health>

Efektet në shëndetin e njeriut

Kërkimet shkencore japin prova se prania e klorpirifosit

në ushqime, mund të lidhet me efekte negative në zhvillimin e sistemit nervor të fëmijëve. Për shembull, EFSA- Autoriteti Evropian i Sigurisë Ushqimore (European Food Safety Authority) ka kryer vlerësime në lidhje me potencialin e këtij rreziku. Ekzistojnë prova të qarta se ky kimikat mund të dëmtojë shëndetin e njeriut.

Historiku dhe Praktikatat e zakonshme të përdorimit të substancave që përmbajnë klorpirifos

Klorpirifosët (metil dhe etil) janë insekticide që i përkasin grupit të përbërjeve kimike të organosfosfateve. Janë insekti-

cide që u prodhuan dhe u futën në treg rreth vitit 1965, në vitin 1965 dhe që atëherë u përdorën intensivisht në mbarë botën, me një përdorim të gjerë si në sektorin privat ashtu edhe në atë tregtar.

Përdorimi:

- Trajtimi i farës/materialit mbjellës.
- Përdorimi direkt në kulturat të ndryshme bujqësore për të luftuar insektet dëmtuese.
- Përdorimi për të luftuar dëmtuesit apo insektet fluturues/mushkonjave.

Konkluzione

Klorpirifosi është një sfida serioze për zinxhirët globalë të furnizimit me ushqime. Me zero tolerancë për mbetjet e këtij kimikati në tregjet esen-

cialë propabiliteti i gjetjeve që rrezikojnë biznesin për shkak të moskonformitetit është më i lartë se kurrë. Nivelet Maksimale të Mbetjeve të përcaktuara së fundmi, do të shkaktojnë refuzimin e çdo produkti të prekur nga ky kimikat. Si rezultat, materialet e tilla nuk do të jenë më të tregtueshme në shkallë të gjerë.

Propabiliteti i mbetjeve të klorpirifos mbi tolerancën zero të deklaruar, mbart një rrezik të lartë mospërrputhjeje dhe refuzimet pasuese. Si pasojë, mallrat e prekura nuk do të jenë më të tregtueshme, duke çuar në humbje të tregjeve të rëndësishme të shitjeve, më në fund.

Veprimet që do të ndërmerren

Kräuter Mix ka rishikuar

politikën e saj për menaxhimin e klorpirifosit në lidhje me zhvillimin e përshkruar.

Kufijtë e mbetjeve do të përcaktohen sipas Nivelit Maksimal të Mbetjeve-MRL-ve zyrtare të Bashkimit Evropian që janë në nivelin e 0.01 mg/kg. Gjetjet që tejkalojnë këtë kufi do të çojnë në refuzimin e materialeve në fjalë. Në një hap tjetër, kufiri i brendshëm i Kräuter Mix, është ulja në kufirin e zbulimit prej 0,005 mg/kg në dhjetor 2021. Të gjithë partnerët e biznesit të Kräuter Mix duhet të sigurojnë që klorpirifos të mos përdoret përgjatë zinxhirëve të tyre të furnizimit dhe që ata të bëjnë të pamundurën për të minimizuar çdo rrezik të kontaminimit të kryqëzuar.

Përshtatur në shqip:

Prof. Dr. Alban Ibrahimi, Universiteti Bujqësor i Tiranës

Burimi:

Kräuter Mix GmbH, D-97355 Abtswind, Gjermany, web: www.kraeuter-mix.de

KËSHILLA NË SHËRBIM TË FERMERËVE

MINISTRIA E BUJQËSISË DHE ZHVILLIMIT RURAL

DREJTORIA E PROGRAMEVE TË ZHVILLIMIT TË BUJQËSISË, SIGURISË USHQIMORE DHE ZHVILLIMIT RURAL

QENDRA E TRANSFERIMIT TË TEKNOLOGJIVE BUJQËSORE VLORE

OPERACIONET E GJELBRA NË HARDHI

Operacionet e gjelbra janë vazhdim dhe përpunim i gjelbra janë vazhdim dhe plotësim i krasitjes dimërore.

Operacione e gjelbra janë ndërhyrje gjatë periudhës vegetative në lastarë, sqetullorë, luleri, gjethe, veshul, kokrra, etj.

Qëllimet që realizohen janë:

- korigjim i gabimeve të krasitjes dimërore, të dukshme dhe të padukshme;

- rregullim i ekuilibrit prodhim-vegjetacion, ku mbahet një formë e caktuar e elementëve të vegjetacionit që zhvillohen normalisht dhe sigurohet prodhimtaria e qëndrueshme në vite;

- rritje e treguesve sasiorë dhe cilësorë të prodhimit padëmtuar vegjetacionin;

Në hardhitë e reja mundësohet një zhvillim i mirë i lastarëve dhe sharmendave të reja ku formohen më mirë dhe më shpejt krahët dhe elementët e tjerë të kurorës, lehtësohen punimet e mekanizuara dhe trajtimet kimike.

Principet bazë të operacioneve të gjelbra

• Rritja dhe prodhimi në raport të drejtë me fuqinë e bimës (sipërfaqja asimiluese).

• Rritja e lastarëve në raport të zhdrejtë me numrin e tyre.

• Rritja e prodhimit (numri i madh i bistakëve) pakëson rritjen vegjetative të hardhisë.

Operacionet e gjelbra mund të kryhen:

1- në trung, krahë, çepa, sharmenda (t' harja).

2- në lastarët e gjelbër (sqetullim, pincim, shkurtim maje, rrallim gjethe, unazim).

3- në bistak (rrallim, ose reduktim i pjesëve të bistakut)

4- në rrënjë (prerje e lastarëve nga n/shartesa, prerje e rrënjëve nga mbishartesa).

I - Heqja e lastarëve të tepërt (T' harja)

Realizon: Një raport të drejtë midis numrit të lastarëve që lihen dhe fuqisë vegjetative të bimës (plus qëllime të tjera).

Parimi i heqjes së tyre: ruajtja e ekuilibrit pjesë ajrore - sistem rrënjor.

Për çdo 1 kg rrush kërkohet jo më pak se 1m² sipërfaqe gjetthore.

Parimi i heqjes së lastëve bëhet sipas natyrës prodhuese të kultivarëve, gjendjes së bimës, klimës, tokës e shërbimeve agroteknike.

Si vepohet: Në hardhitë e reja heqja e lastarëve të tepërt ndikon pozitivisht në formimin e një trugu të trashë, të drejtë dhe të shëndetshëm, mundësohet për dy vitet e para.

Kur nga një syth janë zhvilluar 2-3 lastarë, atëherë lihet vetëm lastari që ka dalë nga sythi kryesor, i zhvilluar mirë. Hiqen binjakët, qofshin dhe me prodhim.

Asnjëherë nuk hiqet lastari i dalë nga sythi i bazës.

Në kultivarët me koeficient të lartë prodhimi hiqen të gjithë lastarët pa prodhim, por dhe me prodhim duke e gjykuar rast pas rasti, sipas nevojave të zhvillimit.

Në kultivarët me bistakë të mëdhenj, por të

pakët, në çdo 2-3 lastarë prodhues, lihet një lastar pa prodhim.



(Foto nga heqja e lastarëve)

Koha: Duhet të bëhet sapo të shfaqen shënjat e para të lulerive, para se të drunjëzohen lastarët, deri në diferencimin e plotë të lulerive.

II-Pincimi dhe prerja e majave - Te hardhitë e reja shpejton dhënie e formës duke shtuar numrin e lastarëve; - Rrit lidhjen e kokrave dhe veshulëve duke kaluar asimilatet drejt tyre nga frenimi 2 javor i prerjes. Nëse nuk pincohet maja e lastarit kryesor atëherë rritet shumë masa vegjative.

Pincimi përdoret: para lulëzimit, sjell zhvillim të madh të masës vegjetative, duke ulur prodhimin. Nëse luleritë vërehet se kalojnë në përdredhëse atëherë pincohen majat, nëprmet së cilës ushqehen lulet dhe formimi i gameteve.



Koha kur kryhet pincimi: Çelja e 5-6 luleve të para.

III-Prerja e majave realizon:

- Ngadalësimin e shpenzimeve të ushqimit nga majat vegjetative dhe uljen e transpiracionit.

- Redukton hijezimin e bistakëve të rrushtit



(Foto nga prerja e majave)

Teknika e kryerjes: sipas natyrës së kultivarit.

Rastet e përdorimit: -para lulëzimit, sjell rritjen e % së luleve të plenuara, rrit numrin e kokrave të formuara, formon veshule të mbushur mirë, prodhim të lartë dhe me pjekje të vonë.

-pas lulëzimit, sjell rritje të kokrave dhe veshulëve, duke shpërndarë normalisht në bimë asimilatet me një proces normal të diferencimit të lulerisë së parë

Drejtorja e Teknologjive të Pemëtarisë: QTTB-Vlorë

E-mail: qttbvlore@yahoo.com

qysh në fund të muajit Maj.

- Nuk rekomandohet prerja e majave të lastarit kryesor kur hardhitë janë të dobëta.

- Në kohë thatësire dhe pa ujti, prerja e majave bëhet më herët duke hequr 6-7 gjethe së bashku me majën e rritjes. Koha e kryerjes: 20-30 Qershor.

IV - Heqja e sqetullorëve (Sqetullimi)

a- Hiqen tërësisht në zonën rreth bistakut dhe pincohen në 4-6-7 gjethe në lastarët e sipërm kur nuk pengojnë trajtimet kimike.

b- Nuk hiqen as në rastet e lastarit që do të shërbejë si sharmend prodhimi vitin pasardhës (ndihmojnë në diferencimin e sythit dhe eliminohet çelja e sythit dimëror).

c- Çdo lastar duhet të ketë 10-15 gjethe për veshul.

Shfrytëzimi për zëvendësimin ose rinovimin e pjesëve të dëmtuara bëhet:

- Në kohë thatësire pa ujti ku lastarët kryesorë janë të dobët, priten majat e tyre duke lënë sqetullorët me 4-5 gjethe,

- Në rastet e dëmtimit të lastarëve nga breshëri, lastarët sqetullorë shfrytëzohen për prodhim të dytë dhe për të rikrijuar pjesët e demtuara.

- Në këtë rast lastarët sqetullorë për prodhim të dytë, lihen me 1-2 veshulë/lastar, pjekja ndodh 3 javë pas pjekjes kryesore. Koha e aplikimit: Kur sqetullori të ketë nxjerë 4-6 gjethe.

V-Unazimi i lastarëve prodhues kryhet

duke hequr me kujdes lëvoren deri në shtresën e jashtme të drurit, me anë të një prerje në formë unaze me gjerësi 3-4 mm, nën bistak.

VI-Heqja e gjetheve të fundit të lastarëve (Rrallimi i gjetheve)

• Operacion i diktuar nga: dendësia e masës vegjetative që pengon ndriçimin, ajrimin dhe shton rrezikun e infeksioneve parazitare (vrugu, hiri dhe kalbëzimi).

• Praktika e gabuar e momentit të heqjes.



Foto e heqjes së drejtë por dhe të gabuar të gjetheve. Foto te cv.Debinë e Bardhë djegur nga dielli (gabim)

(në fazat e para të rritjes së lastarit kur gjetnja kryen rolin e stomakut si tek njeriu).

Qëllimi:

- rritet ndriçimi ajrosje të veshulëve

- ullet infeksionin nga sëmundjet, - rritet sasia dhe

cilësia e prodhimit.

Teknika kryhet në tre nivele:

• Hiqen 2-3 gjetthet e fundit, deri te veshuli i parë,

• Hiqen gjetthet deri te veshuli i fundit, nuk hiqet gjetthja përballë veshulit,

• Hiqet edhe gjetthja përballë veshulit të fundit së bashku me gjetthen e parë të dalë mbi veshul. Kjo masë aplikohet në zonat ku ndriçimi nuk është më i lartë se 40-60 mijë lux.

• Në zonat me ndriçim të lartë diellor hiqen vetëm 2-3 gjetthet e fundit. Ndriçimi dhe temperatura normale konsiderohen kur janë përkatësisht: 20-60 mijë lux dhe 25-30°C.

Koha e aplikimit: -Heqja e gjetheve fillon që nga 3 javë pas lulëzimit deri në fillim të pjekjes së rrushtit.



(Foto nga rrallimi i gjetheve dhe prerje e majave te cv.Shesh i Bardhë - praktik e drejtë)

VII - Veprimet me bistakët

Rrallimi i kokrave dhe veshulëve -rrit madhësinë e kokrave, cilësinë e prodhimit, % e sheqerit (e ëmbëlsimit), -intensitetin e ngjyrosjes së kokrave, - cilësitë tregtare të prodhimit. Rrallimi i kokrave dhe veshulëve aplikohet kryesisht te kultivarët e rrushtit të tavolinës me potencial të lartë prodhimi. - Nuk bëhet rrallimi i kokrave dhe veshulit te kultivarët/bimët me potencial të ulët. Me rrallim hiqen: - veshulët e vegjël jo karakteristikë, nuk kanë shumë kokrra të lidhura, - veshulët afër tokës, - veshulët e prekur nga sëmundjet, - veshulët e hijezuar, etj. Hiqen deri në 30 % e veshulëve.



(Foto nga bimë që kërkojnë rrallim veshulësh) (Foto para dhe pas trajtimit me gibereline të veshulëve)

Koha e aplikimit: rrallimi i kokrave në veshul bëhet kur ka përfunduar rënia natyrale e luleve, kokrave të paplenuara dhe kokrave të zhvilluara dobët. në kohën e lidhjes së kokrës, kur bistaku dallohet plotësisht. Fillon 14-15 ditë mbas mbarimit të lulëzimit. - Bëhet 15-20 ditë pas pllenimit, kur kryhet me spërkatje, me giberelinë (acid giberelik)

Mënyrat e realizimit: - me dorë më e mira; - me preparate, nëpërmjet spërkatjeve gjatë fazës së lulëzimit të plotë me fitohormone që shkaktojnë rrallimin e deri 30-40 % të luleve (ku largohen mbi numrin e planifikuar që kërkojmë).

QENDRA E TRANSFERIMIT TË TEKNOLOGJIVE BUJQËSORE FUSHË KRUIJË

NDIKIMI I BLEGTORISË NË MJEDIS

Blegtoria ka luajtur gjithmonë një rol të vlefshëm pozitiv ndaj mjedisit dhe së bashku me bujqësinë, ajo përbën mburojën kundër varfërit dhe degradimit të tij. Megjithatë, duhet pranuar se praktikata e pamenaxhuara të blegtorisë të çojnë në mënyrë korrekte në prishjen e ekuilibrit të "blegtorisë/mjedisit" me pasojë negative, disa të menjëherëshme, të tjera më të ngadalta në efekt, por jo më pak serioze dhe të rrezikshme për të. Aktiviteti blegtoral ka një ndikim të rëndësishëm në balancat mjedisore, si në nivele lokale dhe globale, në shumë aspekte, duke përfshirë ngrohjen globale, degradimin e tokës, ndotjen e ajrit, ujti si dhe në humbjen e biodiversitetit. Ky ndikim është tashmë mjaft i rëndësishëm aktual-

isht, por po rritet më tej si pasojë e kërkesës në rritje në mbarë botën për produkte me origjinë shtazore (mish, qumësht dhe vezë) dhe për prije gjithnjë e më e theksuar drejt intensifikimit të prodhimit blegtoral.

Ndikimi i blegtorisë në mjedis shprehet në efekte direkte dhe indirekte. Ndër efektet e drejtpërdrejta mjedisore të blegtorisë përfshihen, efektet e kullotjes, efektet e përhapjes së ujërave të zeza në tokë e ujë, konsumi i ujit, emetimi i metanit dhe gazeve të tjera në atmosferë. Ndërveprimet midis blegtorisë dhe mjedisit nuk janë gjithmonë vetëm negative, por edhe pozitive, si avantazhi i përdorimit të plehut organik, kontributi në

drejtim të energjisë motivuese që jep puna me kafshët ende shumë i rëndësishëm në shumë zona të botës.

Ndikimet indirekte lidhen kryesisht me prodhimin dhe transportin e mjeteve teknike të destinuara për mbarështrim, veçanërisht ushqimit për blegtorinë. Ndikimi i blegtorisë në mjedis është bërë më i ndërlidhur nga diversifikimi ekstrem i sistemeve të mbarështrimit në mbarë botën. Lloji i ndërveprimit dhe rëndësia e tij ndryshojnë shumë në varësi të sistemit të mbarështrimit, të teknikave të aplikuar dhe të specieve kafshëve të kultivuara (kafshë monogastrike ose poligastrike, tokësore ose ujore). Blegtoria ndikon në modifikimin e

përbërjes së gazeve në atmosferë nëpërmjet një gamë të gjerë të emetimeve të gazta duke përfshirë, kryesisht, metanin, dioksidin e karbonit, oksidin e azotit dhe amoniakun. Disa nga këto gazra, siç dihet, kanë efekte të rëndësishme në klimën e tokës që duke mbajtur rezatimin e emetuar nga toka, ato kontribuojnë në efektin serrë, dmth ngrohjen e sipërfaqes së tokës e cila është një problem serioz për mjedisin pasi shoqërohet me fenomene si shkrija e akullit, rritja e nivelit të detit, ndryshimi i rezervave ujore, shkretëtirëzimi, ndryshimi i ekosistemeve, zhdukja e llojeve të kafshëve dhe bimëve, rritja e shpeshtësisë dhe ashpërsisë

KËSHILLA NË SHËRBIM TË FERMERËVE

MINISTRIA E BUJQËSISË DHE ZHVILLIMIT RURAL

DREJTORIA E PROGRAMEVE TË ZHVILLIMIT TË BUJQËSISË, SIGURISË USHQIMORE DHE ZHVILLIMIT RURAL

QENDRA E TRANSFERIMIT TË TEKNOLOGJIVE BUJQËSORE FUSHË KRUJË

(Vijon nga faqja 11)

së ngjarjeve ekstreme të motit. Këto dukuri mund të kenë një ndikim të rëndësishëm në biznesin në të ardhmen ekonomike, bujqësi, sigurinë ushqimore dhe shëndetin e popullatës. Bujqësia dhe në veçanti blegtoaria, kontribuojnë ndjeshëm dhe shtojnë problemet e gazeve serrë.

Spektori i blegtorisë është deri tani përdoruesi më i madh i tokës, blegtoaria është përgjegjëse për 18% të emetimeve të gazeve serrë, më shumë se transporti. Nëse marrim parasysh sektorin e bujqësisë në tërësi, vetëm blegtoaria përbën 80% të emetimeve.

Gazrat kryesore të emetuara nga fermat që kontribuojnë në efektin serrë janë: dioksidi i karbonit (CO₂), metani(CH₄) dhe oksidi i azotit (N₂O). Sistemet ekstensive përbën të këndësishëm më të madh se sa ato intensive mbi emetimet e gazeve serrë.

Dioksid karboni

9% e emetimeve antropogjene të dioksidit të karbonit prodhohen nga blegtoaria. Ky gaz i detyrohet jo vetëm zgjerimit të kullotave dhe tokës së punueshme për kulturat foragjere, por edhe përdorimit të energjisë si lëndë djegëse, si ngrohje për ndërtesat blegtorale.

Emetimet e dioksidit të karbonit rrjedhin pjesërisht drejtpërdrejt nga proceset e frymëmarrjes si produkt i aktiviteteve metabolike të kafshëve të kultivuara. Prodhimi i CO₂ rrjedh gjithashtu nga përdorimi i drejtpërdrejtë i energjisë për aktivitetet dhe proceset e mekanizuara që kryhen në sektorin e blegtorisë (ajrimi, ngrohja, mjelja, shpërndarja e ushqimit, etj.) Megjithatë, blegtoaria kontribuon në rrugë indirekte në emetimet e dioksidit të karbonit si nga përdorimi i energjisë për qëllime të prodhimit industrial dhe transportit të mjeteve teknike për mbarështim, si p.sh. ushqim për bagëtinë, aditivë, suplemente, ilaçe dhe pajisje për blegtorinë. Një tjetër mënyrë indirekte përmes së cilës blegtoaria kontribuon në prodhimin e CO₂ është prodhimi industrial i herbicideve, pesticideve dhe plehrave azotike, për kultivimin e foragjereve dhe ushqimit për blegtorinë. Në vendet në zhvillim, burimi i CO₂ vjen shpesh nga modifikimi i përdorimit të tokës si shpyllëzimi i kryer me qëllimin e transformimit zona shkurre, në kullota ose në tokë arë për prodhimin e ushqimit për blegtorinë.

Metani

Për nga rëndësia, metani është gazi i dytë përgjegjës për efektin serrë pas CO₂ dhe gjithashtu do të ishte bashkërisht përgjegjës për reduktimin e shtresës së ozonit. Rreth 37% e emetimeve antropogjene të metanit prodhohen nga blegtoaria.

NDIKIMI I BLEGTORISË NË MJEDIS

Burimet kryesor i metanit është fermentimi enterik i kafshëve mbi të gjitha i ripërtpësve, fermentimet e plehut organik e ujërat e zeza.

Prodhimi i metanit në nivel enterik rrjedh kryesisht nga fermentimi mikrobik të karbohidrateve të pranishme në racionin e kafshëve (celulozë, hemiselulozë, pektinë dhe niseshte) procese të cilat ndodhin në rumenin e ripërtpësve. Sasia e metanit e prodhuar nga kafshët ndikohen nga shumë faktorë, si speciet e kafshëve, niveli produktiv, përbërja e racionit, lloji i karbohidrateve të pranishëm, shkalla e ngopjes së lipideve të pranishme në racion, disa faktorë mjedisore, si temperatura, faktorë gjenetikë të tillë si efikasiteti i konvertimit të ushqimit.

Oksidi i azotit

Oksidi i azotit (N₂O) është një gaz përgjegjës si për efektin serrë ashtu edhe për hollimin e shtresës stratosferike të ozonit, e cila mbron biosferën nga efektet e dëmshme të rrezeve ultravjollcë. Është i pranishëm në sasi të vogla në atmosferë dhe është, gazi i tretë serrë, pas dioksidit të karbonit dhe metanit. Kontributi i vepërimit të blegtorale është i konsiderueshëm, llogaritet se rreth 65% e oksidit të azotit antropogjen rrjedh nga blegtoaria dhe në veçanti nga sistemet ekstensive.

Për sa i përket blegtorisë, prodhimi i oksidit të azotit është i lidhur veçanërisht me konservimin, trajtimin dhe përdorimin e plehut organik blegtoral i cili varet nga metoda dhe kohëzgjatja të këtyre operacioneve por edhe nga lënda e thatë e ujërave të zeza dhe temperatura e ambientit.

Ndikimi i blegtorisë në cilësinë e ajrit nuk lidhet vetëm me ndryshimin e përbërjes së gazeve të pranishme në atmosferë, me pasojat e lartpërmendura në drejtim të ngrohjes globale dhe shiut acid, por përfshin edhe daljen e erërave të këqija për shkak të amoniakut, një problem veçanërisht i rëndësishëm në zonat ku ekziston një afërsi të konsiderueshme midis fermave blegtorale dhe vendbanimeve njerëzore. Prodhimi i aromave varet nga disa faktorë duke përfshirë speciet e kafshëve, përbërja e racionit dhe kushtet mjedisore (temperatura, lagështia, erërat, etj.)

Toka

Totali i zënë nga kullotat dhe kulturat e destinuar për prodhimin e ushqimit për bagëtinë është e barabartë me 70% të sipërfaqes bujqësore të botës. Efekti i aktiviteteve blegtorale në tokë përfshin efekte strukturore,

kimike dhe ekologjike. Proceset e degradimit të tokës si shkretëtirëzimi, erozioni, zvogëlimi i lëndëve organike të pranishme në tokë, ngjeshja dhe kripëzimi mund të bëjnë që toka të humbasë aftësinë për të kryer funksionet e saj kryesore. Këto procese degradimi mund të shkaktohen nga praktikatat e gabuara bujqësore për prodhimin e ushqimit për blegtorinë (plehërimi i pabalancuar, nxjerrja e tepërt e ujit nëntokësor për qëllime ujite, monokulturë), kullotje jo racionale ose së fundi nga shpyllëzimi. Për sa i përket erozionit të tokës, blegtoaria kontribuon në këtë fenomen ndrejtërdrejt, si rezultat i shkeljes me këmbë dhe kullotjes dhe indirekt nga kultivimi i bimëve për ushqimin e bagëtive, veçanërisht kur kjo kryhet në një mënyrë intensive dhe sipas praktikave jo të vëmendshme për parandalimin e erozionit. Intensifikimi i aktivitetit blegtoral në përgjithësi shoqërohet me intensifikimin e aktivitetit bujqësor lidhur me prodhimin e ushqimit për bagëtinë e cila përkthehet në rritje të përdorimit të plehrave të cilat mund të shkojnë përtej nevojave të bimëve të kultivuara dhe përtej aftësisë së tokës për të mbajtur lëndë ushqyese. Nëse këto lëndë ushqyese janë relativisht të palëvizshme dhe pak të tretshme në ujë (të tilla si fosfatet e patretshme) ato grumbullohen në tokë duke modifikuar strukturën dhe karakteristikat e saj. Anasjelltas kur ato janë të lëvizshme (si azoti, kaliumi dhe disa forma të fosforit) ndikojnë kryesisht në ujërat sipërfaqësore ose nëntokësore. Bujqësia intensive, e cila shoqërohet me blegtori intensive, bazohet në një përdorim të rëndësishëm të pesticideve me rreziqet pasuese të akumulimit në tokë dhe ndotjes së ujit të cilat kanë veti specifike që mund t'i bëjnë të rrezikshme për shëndetin dhe mjedisin. Rreziku i ndotjes së ujit që lidhet me aktivitetet blegtorale gjithashtu është i lidhur me ndotjen që vjen nga ujërat e zeza të proceseve të ndryshme të thertoreve, përpunimit të qumështit, fabrikave të lëkurës.

Uji

Spektori i blegtorisë ka një ndikim të madh në përdorimin e ujit, cilësinë e ujit dhe ekosistemet ujore. Marrëdhënia midis blegtorisë dhe ujit ka të bëjë si me aspektin sasior, të lidhur me përdorimin e burimeve ujore për mbarështim dhe në atë cilësor i lidhur me rrezikun e ndotjes së ujit i shkaktuar nga mbetje blegtorale, plehraj sintetike dhe pesticide të përdorura në bujqësi dhe blegtori intensive. Prodhimi blegtoral ka një ndikim

të fortë në disponueshmërinë e ujit, pasi konsumon më shumë se 8% të përdorimit të ujit nga njerëzit në nivel global, kryesisht për ujtjen e kulturave foragjere. Në zonat me burime të pakta ujore, sasia e ujit të përdorur për prodhimin e kafshëve mund të tejkalojë atë që përdoret për të plotësuar nevojat e njerëzve për ushqim. Blegtoaria është burimi më i madh sektorial i ndotësve të ujit, kryesisht mbetje shtazore, antibiotikët, hormonet, kimikatet e fabrikës së lëkurës, plehra dhe pesticide të përdorura për kulturat foragjere. Uji përdoret për ujtjen të kulturave të destinuar ushqimin e bagëtive, për plotësimin e nevojave të tyre për ujë, për operacionet e mbarështimit në veçanti për pastrimin, përpunimin e lëndëve të para me origjinë blegtorale (thertore, industri bulmeti, përpunimi i lëkurës, etj.).

Biodiversiteti

Faktorët që ndikojnë negativisht në biodiversitet janë kryesisht ndryshimet në përdorimin e tokës, ndryshimet klimatike, futja e specieve dominuese dhe ndotja. Reduktimi i biodiversitetit të kafshëve që rezultojnë nga mbarështimi i atribuohet kryesisht rritjes së konkurrencës për sipërfaqet midis kafshëve shtëpiake dhe kafshëve të egra dhe ndryshimi i përdorimit të tokës që rezultojnë në shkatërrim, fragmentim dhe degradim i habitateve të disa specieve. Përveç kësaj shpyllëzimi dhe shkretëtirëzimi, gjithashtu i lidhur me mbarështimin e kafshëve, ndihmojnë në reduktimin e hapësirave dhe burimeve për mbijetesën e kafshëve të egra. Komponenti i rëndësishëm që ndikon në biodiversitet është humbja e burimeve gjenetike për shkak të zhdukjes së racave të blegtorisë, të cilat kanë çuar në një reduktim progresiv të racave autoktone në favor të atyre kozmopolite.

Sipas një raporti të FAO-s rekomandohet disa veprime për të ulur ndikimin e blegtorisë në mjedis.

- Restaurimi i tokës së dëmtuar, menaxhimi më i mirë i sistemeve të kullotjes, mbrojtja e zonave të ndjeshme.

- Menaxhimi i qëndrueshëm i prodhimit bujqësor dhe foragjereve, ushqim i përmirësuar i kafshëve, menaxhimi i plehut organik për të reduktuar emetimet e metanit dhe të azotit.

- Menaxhimi më i mirë i mbetjeve të kafshëve, ushqim më i mirë për të përmirësuar përthithjen e lëndëve ushqyese, përdorim më i mirë i plehut organik të përpunuar në tokën bujqësore.

- Mbrojtja e përmirësuar e zonave të pacënuara, mirëmbajtja e lidhjes ndërmjet zonave të mbrojtura, integrimi i prodhimit të kafshëve dhe prodhuesve në planifikimin e përdorimit të tokës.

Përgatiti: Flutura Sala, Albi Shehu

QENDRA E TRANSFERIMIT TË TEKNOLOGJIVE BUJQËSORE KORÇË

1. Për fermat e dhenve

Ndodhemi në sezonin kur duhet të kryhet procesi i qethjes së dhenve kryesisht në zonat fushore të vendit tonë. Për të bërë qethjen uniforme dhe për ta realizuar sa më shpejt këtë proces është mirë të përdoren qethëset mekanike, të cilat janë të thjeshta në përdorim dhe rezultative.

Menjëherë mbas qethjes kryhet trajtimi i dhenve kundër parazitëve të jashtëm (zgjebe, morra, pleshta etj) këshillimi me Veterinerin, si edhe dehelmintizimi për parazitizat e aparatit tretës (trajtimi rutinë në pranverë).

Para se delet të shkojnë në kullotat malore bëhet përgatitja e stanit (për ato ferma të cilat aplikojnë shtegëtimin). Nëse tufa/tufat vendosen në të njëjtin stan të viteve të mëparshme, para shtegëtimin bëhet heqja e plehut dhe dezinfektimi i vathave ku do të verojnë kafshët. Kryhet parcelizimi i kullotës duke përcaktuar parcelat sipas periudhave: për periudhën e qumështit, për periudhën e ndërimit (flushing) dhe për periudhën e vjeshtës. Ndarja e parcelave të kullotës malore të përcaktohet në mënyrë të tillë për bërë të mundur ripërtëritjen e kullotave, duke bërë lëvizje nga lartësitë më të ulta në ato më të larta dhe anasjelltas. Duhet bërë kujdes me sëmundjen e çalës (Nekrobaciloza e thundrave) e cila është shumë problem-

KËSHILLA PËR FERMERËT QË MBARËSHTOJNË BAGËTI TË IMTA

atike. Për masat parandaluese dhe mjekimin e saj këshillimi bëhet me veterinerin.

Duhet të kryhet trajtimi i qengjave kundër sëmundjes së Diktiokaulozës (qimza). Këshillohu me veterinerin.

Për fermerët e dhive

Ndodhemi në sezonin kur është bërë shkëputja e kecape dhe dhitë janë në mjelje të plotë.

Për të prodhuar qumësht të pastër dhe për të mbrojtur gjirin e dhive ju këshillojmë që të zbatoni rregullat e mjeljes dhe manipulimit të qumështit.

- Qumështi i dhive është tepër i predispozuar për t'u kontaminuar nga agjentët mekanikë, fizikë dhe mikrobikë prandaj ndiqni këtë procedurë mjelje:

• Dhitë të milen në një vend të veçantë dhe të pastër, të ndarë nga zona e ndenjes së kafshëve për të mënjanuar kontaminimin nëpërmjet ajrit dhe plehut.

• Kryhet pastrimi i gjirit dhe i thithave (papilave).

• Shtydhjen pikat e para në një gotë të posaçme për

këtë qëllim.

• Higjiena duhet të sigurohet edhe nga vetë fermeri që bën mjeljen duke larë duart dhe të ketë një veshje të përshtatshme për këtë proces. Nëse lëkura e duarve është e irrituar apo e infektuar të përdoren doreza plastike gjatë procesit të mjeljes.

• Para se të milet kafsha kontrollohet pamja e pikave të para të qumështit.

• Kujdes nga Insektet: mizat, brejtësit, kafshët e tjera dhe zogjtë sepse mund të ndotin ambientin dhe qumështin, por që edhe mund të bëhen burim infeksioni për sëmundje të ndryshme infektive.

Numri i bakterieve në enë qumësht është direkt i lidhur me higjenën e ambientit dhe manipulimin e qumështit. Qumështi duhet të kontrollohet para se të milet për anomali të ndryshme aromë e strukturë (vlerësimi i cilësive organoleptike). Kafshët me qumësht jo normal duhet të milen në fund dhe qumështi i tyre nuk duhet përdorur (eliminohet).

• Sipërfaqet e enëve që kanë kontakt me qumështin

Drejtorja e Teknologjive Blegtorale: QTTB- Korçë:
E-mail: qttbkorce@yahoo.com

duhet të lahen shumë mirë dhe të dezinfektohen.

• Qumështi menjëherë mbas mjeljes duhet të ftohet duke iu referuar normave të standardeve të vendosura me ligj, në 4 gradë C brenda 2 orëve të mjeljes dhe mbahet në këtë temperaturë deri sa të dorëzohet në baxhon e përpunimit.

• Qumështi nuk duhet të mbahet në ambientet e stallës. Mbjatja për një kohë të gjatë në dritë natyrale apo artificiale duhet të evitohet. Edhe gjatë transportit duhet të mbahen temperaturat e ruajtjes së qumështit.

• Qumështi para se të dërgohet në enën ruajtëse apo tankun ftohës duhet të jetë i kulluar mirë për të eliminuar çdo mbetje fizike. Pajisjet e kullimit duhet të jenë të pastra.

• Kujdes i vecantë i duhet kushtuar në këtë periudhë vaksinimit të dhive kundër sëmundjes së Agalaksisë/ Hirës (sëmundje infektive ngjitëse), e cila dëmton në mënyrë mjaft të ndjeshme gjirin e kafshës (mastit i rëndë) dhe që në disa raste e çon kafshën deri në ngordhje.

• Është gjithashtu momenti që për tufën e dhive të kryhet remontimi i kësaj tufe me kecat të cilët kanë gjeoneallogji të mirë duke i vlerësuar nga paraardhësit që kanë vlerat racore dhe produktive më të larta. Këshillimi me specialistin e fushës.

Për sqarime të tjera kontaktoni:
Sotiraj Jankulla cel: 0682630700
E-mail: sotirajankulla@yahoo.com

REZOLUTA

(Vijon nga faqja 3)

Tryeza Tematike dhe Forumi i Agrobiznesit “Bujqësia, Turizmi Rural dhe Mjedisi në Zonat Rurale në Shqipëri”

Të përcaktojë si një ndër objektivat prioritare të Strategjisë për Zhvillimin Bujqësor e Rural dhe Peshkimin 2021-2027 edhe konsolidimin e Procesit të kooperimit dhe koordinimit.

Të ngrejë sektor të vaçant në ministri dhe AREBE, për mbështetjen dhe ndjekjen e procesit të kooperimit dhe koordinimit.

Të nxisë dhe mbështes institucionet e arsimit të lartë, institucionet e varësisë dhe të orientojë e inkurajojë donatorët, për të vlerësuar dhe kontribuar me prioritet në realizimin e disa objektivave, për konsolidimin e procesit të kooperimit dhe koordinimit duke filluar me projektin pilot.

Të nënshkruajë një Memorandum Bashkëpunimi me KASH dhe me organizata të tjera, që kanë prioritet realizimin e objektivave të sipërcituara, për konsolidimin e Procesit të Kooperimit dhe Koordinimit në sektorët e Bujqësisë, Turizmit rural dhe Mjedisit në zonat rurale.

Ministritë Turizmit dhe Mjedisit i propozohet:

Të angazhojë strukturat e veta, të nisin nga puna paralelisht, për të mundësuar hartimin dhe miratimin në Këshillin e Ministrave, të Planit Rajonal të Menaxhimit të Integruar të Mbetjeve Organike, duke filluar me Prefekturën dhe Qarkun e përzgjedhur si pilot nga sektori privat, për të ndërton modelin e duhur, për zbatimin e masave të propozuara për konsolidimin e Procesit të Kooperimit dhe Koordinimit.

Sektori i Përgjithshëm dhe Fizibilitetit të Projekteve për Pastrimin e Mjedisit dhe Trajtimit e Mbetjeve të bashkëpunojë me KASH, për adresimin dhe zgjidhjen e problemeve, që kanë krijuar dhe do të krijojnë rreth 1 milion ton mbetje organike, që gjenerohen mesatarisht çdo vit në zonat rurale në Shqipëri. Gjithashtu dhe marrjen e masave për rritjen e efikasitetit ekonomik e mjedisore të zonave të mbrojtura.

Agjencia Kombëtare e Mjedisit (AKM) të bashkëpunojë me strukturat e pushtetit vendor dhe KASH, për të lehtësuar procedurat dhe procesin e përcaktimit të venddepozitimeve, si dhe dhënien e lejeve mjedisore, për SHB, federatat dhe konfederatën, që kanë si objekt kryesor grumbullimin, depozitimin, transportin, përpunimin dhe riciklimin e mbetjeve organike.

Inspektorati Shtetëror i Mjedisit dhe Pyjeve (ISHMP) të bashkëpunojë me prefekturën për të përkrahur veprimtarinë e KASH dhe organizatave si motra, duke hartuar e zbatuar një plan të veçantë kontrolli, për subjektet prodhuese dhe ato familjare, për zbatimin e legjislativit aktual mjedisor në territorin e Prefekturës dhe Qarkut të përzgjedhur për t'u zbatuar Projekti pilot.

Komiteti për Menaxhimin

e Integruar të Mbetjeve në mbledhjen e radhës të diskutojë për problemet dhe zgjidhjet e propozuara në këtë rezolutë. Gjithashtu të diskutojë edhe kërkesën e KASH për t'u bërë anëtar i këtij komiteti.

Institucioneve të arsimit të lartë, Universitetit Bujqësor Tiranë, Universitetit “Luara-si”, Universitetit “Polis”, Universitetit “Eqerem Çabej” në Gjirokastrë, të cilët pak kohë më parë kanë nënshkruar edhe një Memorandum Bashkëpunimi me KASH, u sugjerohet: Të angazhohen për të organizuar kurse të posaçme kualifikimi dhe të paisin me certifikata stafet drejtuese të Shoqërive të Bashkëpunimit, të Klasterave, të Federatave dhe Konfederatës së tyre. Gjithashtu dhe ekspert për vlerësimin e tokës, pyjeve, kullotave dhe aseteve të tjera në zonat rurale. Të marrin pjesë gjerësisht në procesin e zbatimit të censurit të radhës së bujqësisë.

Këshillit të Agrobiznesit Shqiptar KASH, në bashkëpunim me shoqatat si motra, që e kanë nënshkruar tashmë Memorandumin e Bashkëpunimit me KASH, por edhe me përfaqësues nga secili subjekt pjesëmarrës në “Tryezën tematike” të datës 29 prill 2022, si dhe në Forumin e dt. 20 maj 2022 në Lushnjë, të angazhohet për ngritjen dhe funksionimin periodik të një Këshilli konsultativ kombëtar për Bujqësinë, Turizmin Rural dhe Mjedisin në zonat rurale, i cili të formulojë dhe propozojë institucioneve publike dhe private një paketë me të detajuar masash për zgjidhjen e problemeve. Gjithashtu përmes botimit periodik 15 ditor të Gazetës “Agrobiznesi” të informojë publikun e ndjek zbatimin e konkluzioneve të rezolutës dt. 20 maj 2022 në Lushnjë.

Mekanizimi, Inovacioni dhe Dixhitalizimi në sektorët e Bujqësisë, Turizmit Rural dhe Mjedisit në Zonat Rurale, janë instrumente eficientë dhe rruga e duhur për të ulur koston, rritur rendimentin, për të përballuar edhe mungesën e fuqisë punëtore në këta sektorë dhe jo vetëm dhe veçanërisht në këtë situatë krize që është ekonomia.

Mekanizimi në Sektorin e bujqësisë dhe Mjedisit:

Familjet fermere në Shqipëri e përdorin traktorin për punimin e tokës në masën 54 %. Pjesa tjetër e punojnë tokën me krahë ose kafshë pune. **Shqipëria përdor 1.24 traktor/100 ha tokë bujqësore,** ndërsa Maqedonia e Veriut 6 traktor / 100 ha, Greqia ka 6.6 traktor/100 ha, Italia 13.2 traktor/100 ha, Gjermania 10.8 traktor/100 ha, BE 8.1 traktor

/100 ha. Shqipëria përdor për kultivimin e bimëve 1.5 makineri të ndryshme bujqësore për cdo traktor, vendet e rajonit përdorin mesatarisht 5-7 të tilla, ndërsa BE 13 makineri bujqësore /traktor. Mekanizimi procesit dhe paisja e subjekteve me mjete mekanike të specializuara për grumbullimin dhe përpunimin e mbetjeve organike dhe ruajtjen e mjedisit në zonat rurale është tejet i limituar dhe i panjohur.

Për përmirësimin e situatës së mekanizimit në këta sektorë kërkohet:

MBZHR të përcaktojë si një ndër objektivat prioritare të Strategjisë për zhvillimin bujqësor e rural dhe peshkimin 2021-2027 edhe procesin e rinovimit të parkut të mjeteve të mekanikës bujqësore.

Mbështetje procesit dhe iniciativave që janë marrë për konsolidimin e tokës. Dhe në këtë kuadër duhet mbështetur modeli dhe konkluzionet e aritura në përfundim të zbatimit të një Projekti pilot, për konsolidimin e tokës në Qarkun Fier, i drejtuar nga Prof. Sherif Lushaj.

Rritja në vijimësi e masës së subvencionit për reduktimin e çmimit të karburantit, lubrifikanteve, si dhe reduktimin e çmimit të energjisë elektrike që konsumohet nga dhomat frigoriferike, për ruajtjen e prodhimeve bujqësore. Mbështetje me grante dhe lehtësi fiskale për importin e traktorëve, paisjeve e mjeteve bujqësore, veçanërisht atyre për mekanizimin e vjeljes së prodhimeve bujqësore.

Formalizimi i mjeteve të mekanikës bujqësore ekzistuese duke mundësuar pajisjen me targa, leje qarkullimi, leje drejtimi të posaçme. Përgatitja e një Rregjistrimi elektronik të mjeteve të mekanikës bujqësore, linjave të agropëpunimit, serrave të rendimentit të lartë të ndërtaura me teknologji të përparuar, për t'i përdorur edhe si asete kolaterali për marrje kredie. Mbështetje për rihapjen e kurseve të kualifikimit për drejtimin e mjeteve bujqësore në qendrat e agroserviseve.

Mbështetje me grante për pajisjen me mjete mekanike të specializuara, me teknologji bashkëkohore të shoqërive të bashkëpunimit, federatave, konfederatës dhe klasterave të angazhuara në zbatimin e Projektit pilot, në procesin e grumbullimit dhe përpunimit të mbetjeve organike në zonat rurale, për prodhimin e plehut organik të pastër dhe përmirësimin e situatës mjedisore në zonat rurale..

Inivacioni dhe Dixhitalizimi vlerësohet se:

MBZHR e ka përcaktuar fushën e inovacionit dhe dixhitalizimit, si një ndër objektivat prioritare të Strategjisë për Zh-

villimin Bujqësor e Rural dhe Peshkimin 2021-2027. Shqipëria për përdorimin e inovacionit dhe dixhitalizimit e ka aprovuar tashmë një kuadër ligjor bashkëkohor.

Ka një shtrirje e përdorimit të internetit dhe telefonise mobile edhe në zonat rurale. Gjithashtu për përdorimin e tyre është fituar përvoja e domosdoshme nga një masë e konsiderueshme subjektsh dhe individësh edhe në zonat rurale.

Është moment i duhur që të intensifikojmë punën, për të mundësuar marrjen e sa më shumë shërbimeve nga fermerët përmes kartës elektronike.

Duhet të fillojë pa humbur kohë edhe studimi, për krijimin e një Qendre të posaçme për rregjistrimin dhe ndjekjen e veprimtarisë së subjekteve të agrobiznesit. Kemi aktualisht në përdorim edhe për zonat rurale disa iniciativa dhe modele dobiprurëse si:

Platforma elektronike **ABA Online** e institucioni financiar FED Invest mbështetur nga JICA. Platforma elektronike **Agroweb** e projektit CBS mbështetur nga USAID.

Platforma elektronike **Vodafone smart agriculture**, e zbatuar nga kompania Doni Fruit, **Field Climate** e zbatuar nga Kompleksi Agroturistik UKA FARM, mbështetur fillimisht nga Vodafone Albania, etj.

Gjithshshtu shumë dobiprurëse janë dhe duhet mbështetur zbatimi i konkluzioneve dhe rekomandimeve të studimit **Dixhitalizimi në sektorin privat** i kompanisë “PROTIK” mbështetur nga Projekti Risi Albania. Përdorimi masivisht i instrumenteve të tjerë të kontrollit dixhital në distancë, janë shumë të rëndësishëm jo vetëm për marrjen në kohë të informacionit për parandalimin e pasojave negative, por edhe për të përmirësuar procesin e gjurmueshmërisë në sektorët e Bujqësisë, Turizmit Rural dhe Mjedisit në Zonat Rurale dhe jo vetëm.

Janë këto disa modele të suksesshme të realizuara nga sektori privat, me mbështetje të donatorëve, që akoma duhen mbështetur, inkurajuar, promovuar e plotësuar edhe me rubrika të reja, për t'i aplikuar e zbatuar gjerësisht në Sektorët e Bujqësisë, Turizmit Rural dhe përmirësimit të Mjedisit në Zonat Rurale, si dhe në të gjithë sektorët e Ekonomisë së Ushqimit.

Financimi dhe Disbursimi i Fondeve Grant:

Vlerësohet se aktualisht jemi përpara një situatë dhe disa fakteve, që për sektorin e Bujqësisë dhe Turizmit rural, nga sektori privat kemi akoma iniciativa, dëshirë, por edhe burime të konsiderueshme për financim përmes remitancave

dhe burimeve të tjera të brendshme të subjekteve private. Amnistia fiskale e premtuar prej kohësh, po të zbatohet do të ndikonte pozitivisht në këtë proces.

Banka e Shqipërisë dhe bankat e nivelit të dytë kanë filluar të ndryshojnë politikën, duke programuar më shumë fonde të mundshme, për t'u përdorur si kredi për zhvillimin e bujqësisë dhe mbështetjen e subjekteve, që operojnë në zonat rurale në sektorin e agroturizmit.

BERZHI ka angazhuar 180 milion euro, për të nxitur e garantuar bankat e nivelit të dytë, që të kreditojnë bujqësinë dhe zhvillimin rural në Shqipëri me kushte lehtësuese.

Qeveria përmes buxhetit për çdo vit po mbështet me grante përmes skemave kombëtare të posaçme fushën e financimit të bujqësisë dhe subjektet që operojnë në zonat rurale, siç është garancia sovraane për kolateralin prej një miliard lek. Financimet për programin e zhvillimit të 100 fshatrave, që duhet të mos ndërpritet si program. Financimi grant prej 1.4 miliard lek/vit, për subvencionimin pjesor të çmimit të karburantit që përdoret për punimet në bujqësi.

BE dhe Qeveria shqiptare në kuadër të programit për mbështetjen e bujqësisë dhe zhvillimit rural përmes programit IPARD III kanë miratuar programin e financimit grant për 146 milion euro. Program që do të startojë nga viti 2022.

Emigrantët çdo vit përmes remitancave, por edhe ata që po kthehen kanë investuar dhe akoma duan që të financojnë për investime në bujqësi, agroturizëm, në hallkat e tjera të zinxhirit ushqimor dhe në zhvillimin rural.

Institucionet financiare ndërkombëtare kanë programuar fonde grant të konsiderueshme për mbrojtjen e mjedisit dhe parandalimin e pasojave negative, që vijnë si rezultat i përkeqësimit të kushteve klimatike, për të cilat duhet më shumë vlerësim, iniciativa e masa konkrete për të përfutur prej Tyre.

Por në fushën e financimit dhe disbursimit të fondeve grant janë edhe disa probleme specifike që kërkojnë zgjidhje:

Problem madhor për fermerët dhe të gjitha hallkat e zinxhirit ushqimor mbetet niveli i pamjaftueshëm i fondeve të planifikuara çdo vit nga buxheti shtetit për institucionin e MBZHR. Buxheti vjetor i MBZHR duhet rritur minimum me 60 %, që t'i mundësojë sektorit privat të vijojë të rrisë investimet përmes financimit të projekteve eficiente, si me burimet e veta financiare, ato me kredi nga institucionet financiare dhe të mund të disbursojë totalisht fondet grant të vëna në dispozicion nga buxheti, nga BE, nga

donatorë dhe institucione të tjera financiare.

Problem i pazgjidhur mbetet kërkesa e KASH dhe shoqatave si motra për heqjen dorë nga paditë civile në të gjitha shkallët e gjyqësorit dhe faljen e debitorëve që rezultojnë si pasojë e veprimtarisë së firmave piramidale. Ata që përfituan mjete bujqësore dhe linja agropëpunimi nga grantet e dhëna për fermerët nga Qeveria e Japonisë, përmes Projektit Rritja e Prodhimit Ushqimor 2KR dhe Non Projekt Grant Aid, grante që padrejtësisht për motive politike u kthyen në kredi me interesa e kamatëvonesa për fermerët.

Problem tjetër madhor për fermerët dhe të gjitha hallkat mbetet ritmi i ulët i procesit të paisjes së pronarëve në zonat rurale me certifikatat e pronësisë nga Agjencia e Kadastrës. Agjensisë së Kadastrës i duhet dhënë një hartë e projekteve prioritare, që sektori privat parashikon të investojë aktualisht, në mënyrë që Agjencia e Kadastrës të trajtojë me prioritet formalizimin e pronës në këto zona dhe subjektet që duan të investojnë të mos presin me vite deri sa të përfundojë procesi dishitalizimit të pasurisë në të gjithë vendin nga Agjencia e Kadastrës.

Taksat dhe Tarifat e larta që shpesh vendosen pa u studiuar dhe në mënyrë abuzive nga pushteti vendor, për veprimtarinë në zonat rurale, por edhe për investimet në bujqësi dhe në të gjitha hallkat kryesore të zinxhirit ushqimor. Kërkohet një koordinim më i mirë midis dy niveleve të pushtetit qendror dhe vendor, për të mos mbivendësuar e rritur jashtë logjikës ekonomike taksat dhe tarifën e ndryshme.

Paketa fiskale aktuale për sektorin e Bujqësisë duhet rishikuar. Ajo ka sjellë pasojë negative me ndryshimet e shpeshta, në disa raste pa studime të thelluara, pa argument bindës dhe të pa konsultuara me grupet e interesit. Ndryshimet kanë rezultuar me efekte të dëmshme ekonomike e financiare për fermerët dhe subjektet që operojnë në hallkat e zinxhirit ushqimor, por edhe të ardhurat në buxhetin e shtetit nuk janë rritur sipas parashikimit.

Përmirësimi kuadrit ligjor:

Paketa ligjore e domosdoshme e propozuar nga KASH, në konsultim e mbështetje edhe nga shoqatë si motra në vend, për të fituar kohë sugjerohet që të përgatitet e miratohet në bllok, si një paketë e vetme. Gjithashtu në këtë situatë krize të gjatë sugjerohet të përdoren rregullat dhe procedura e ndjekur për hartimin dhe miratimin e akteve normative. Paketa propozohet të përbëhet nga disa ligje kryesore:

Ligji nr.7747 datë 28.07.1993 “Për hidrokarburët (kërkimi dhe prodhimi)” i

(Vijon në faqen 14)

REZOLUTA

(Vijon nga faqja 13)

ndryshuar;

Ndryshimet e propozuara në këtë ligj do të mundësojnë dhe lehtësojnë procesin e reduktimit të çmimit të karburantit, duke e përcaktuar me ligj për tu përdorur nga fermerët sasia prej 10 % e karburantit prodhim vendi, që shteti përfiton falas nga shoqëritë konçensionare të nxjerrjes së naftës.

Kodi Rrugor i Republikës së Shqipërisë; Miratuar me ligjin nr. 8378 date 22.07.1998, ndryshuar me ligjin nr. 9808 date 24.09.2007 dhe ligjin nr. 10488 date 05.12.2011.

Ndryshimet në këtë ligj dhe nxjerrja e akteve nën ligjore do të mundësojnë rritjen e efikasitetit së veprimtarisë së mjeteve të mekanikës bujqësore. Do të reduktojnë dhënien dhe marrjen e ryshfetit dhe rrisin efikasitetin dhe sigurinë e jetës së punonjësve që punojnë në këtë sektor.

Ligji nr. 62/2012 "Për Akcizat në Republikën e Shqipërisë":

Ndryshimet në këtë ligj duhen për të mundësuar reduktimin e kostove të prodhimit të lëndëve të para në vend dhe do të ndihmojnë për të bindur fermerët, që të realizohet sa më parë procesi formalizimit.

Ligji nr. 38/2012 "Për Shoqëritë e Bashkëpunimit

Tryeza Tematike dhe Forumi i Agrobiznesit "Bujqësia, Turizmi Rural dhe Mjedisi në Zonat Rurale në Shqipëri"

Bujqësor";

Propozimet e bëra për amendimet në këtë ligj dhe miratimi akteve nënligjore janë një kusht i domosdoshëm dhe i nevojshëm, për të zbatuar në praktikë dhe realizuar objektivat kryesore që janë shkruar më sipër në këtë P/Rezolutë, veçanërisht për përmirësimin dhe konsolidimin e procesit të kooperimit dhe koordinimit. Ligji aktual është bërë tashmë një pengesë për këtë proces.

Ligji nr. 9817 datë 22.10.2007 "Për Zhvillimin Bujqësor Rural".

Ndryshimet "Për disa shtesa dhe ndryshime në ligjin Nr. 9817, datë 22.10.2007 "Për bujqësinë dhe zhvillimin rural", të propozuara nga KASH, mundësojnë realizimin me efikasitet më të mirë të skemës mbështetëse, për të gjithë shtresën e agrobiznesit dhe në mënyrë më të veçantë grupimin e fermerëve, produktet e të cilëve gjenden në situatë të pafavorshme krahasuar me produktet e vendeve të rajonit dhe ato komunitare, si pasojë e nivelit të ulët të mbështetjes strukturore, që ofrohet për këtë sektor të ekonomisë në mënyrë të krahasuar.

Gjithashtu niveli i mbështetjes direkte apo nëpërmjet lehtësive fiskale, i dhënë Bujqësisë, Turizmit Rural dhe Mjedisit në Zonat Rurale, është tepër larg ndaj limitit të negociuar dhe miratuar në kuadër të Marrëveshjes me Organizatën Botërore të Tregtisë (OBT) dhe atë rajonale (CEFTA). Ndryshimet e propozuara, përveç realizimit të skemës mbështetëse, parashikojnë mundësinë e rritjes së bashkëveprimit të agjencisë së pagesave me organizatat e shoqërisë civile që veprojnë në zonat rurale bazuar në arsyetimin që shoqëria civile zotëron kapacitetet njerëzore dhe teknike që të kryejë shërbime shtesë që nuk përbushen nga sektori publik për shkak të mungesës së aftësive dhe kostos shumë të lartë në kryerjen e këtyre shërbimeve. Rëndësia dhe roli i shtuar i organizatave të shoqërisë civile është përfundim në disa dokumente ndërkombëtar si Dokumenti për Partneritetin e Busanit¹, të cilin shteti Shqiptar e ka mbështetur, ku theksohet roli i organizatave të shoqërisë civile në ofrimin e shërbimeve në fusha që janë plotësuese të shërbimeve që ofrohen nga

shteti². Gjithashtu, edhe në Komunikatën e Komisionit të Bashkimit Europian³ theksohet roli që luajnë organizatat e shoqërisë civile në kryerjen e shërbimeve të cilat plotësojnë shërbimet e kryera nga organet e qeverisjes vendore dhe qendrore. Për më tepër përzgjedhja e këtij modeli bashkëpunimi ndërmjet organeve të specializuara të shtetit dhe shoqërisë civile parashikohet dhe nxitet edhe nga rregulloret e Këshillit të Bashkimit Evropian që rregullojnë bujqësinë dhe zhvillimin rural⁴.

Ligji 7501 dt. 19.07.1991 "Per Tokën Bujqësore", megjithëse i janë bërë amendime, shtesa e ndryshime të shumta, përsëri kërkohet të

amendohet, për të stabilizuar problemin e lënies së tokës djerrë, copëzimit të vazhdueshëm të parcelave, si rezultat ndarjeve të pjestarëve të familjes, rritjen e efikasitetit së përdorimit, si nga pronarët dhe përdoruesit.

Miratimi një ligji të ri "Për parandalimin dhe menaxhimin e rrisit" në Bujqësi, Turizmin Rural dhe Mjedisit në Zonat Rurale ka qenë dhe mbetet një nga kërkesat e vazhdueshme të KASH dhe një domosdoshmëri emergjente për sektorët e Bujqësisë, Turizmit Rural dhe Mjedisit në Zonat Rurale. Përkeqësimi i kushteve klimatike, shoqëruar me katastrofa të shpeshta natyrore, me shtim të rasteve nga

dëmtuesit dhe sëmundjet, si dhe pamundësia e subjekteve që punojnë në këta sektorë për të përballuar primin e sigurimit që ofrojnë shoqëritë e sigurimit e bëjnë të domosdoshëm miratimin e një ligji të posaçëm, për të mundësuar përballimin e çmimit të primit të sigurimit nga tre aktorë, subjekti privat, buxheti i shtetit dhe fondet grant të donatorëve apo institucioneve financiare.

Gjithashtu, miratimi i një ligji të ri "Për rritjen e aksesit në financë duke përdorur si kolateralaturat dhe prodhimet bujqësore" mbështetur nga qeveria e Zvicrës dhe IFC, konsiderohet si një model dhe kontribut mjaft dobiprurës për sektorët e Bujqësisë, Turizmit Rural dhe Mjedisit në Zonat Rurale.

Agim Rrapaj Kryetar i KASH

¹ URL: <http://www.oecd.org/dac/effectiveness/49650173.pdf>

² Shikoni neni 22 të Dokumentit për Partneritetin e Busanit: "Organizatave të shoqërisë civile (OSHC) luajnë një rol thelbësor në krijimin e mundësive për njerëzit që të kërkojnë të drejtat e tyre, në promovimin e qasjeve që bazohen tek të drejtat, në formimin e politikave dhe partneriteteve për zhvillim, sidhe në mbikqyrjen e zbatimit të tyre. Ata, gjithashtu, ofrojnë shërbime në fusha që janë plotësuese me ato që ofrohen nga shteti. Duke njohur këtë, ne do të:

a) zbatojmë plotësisht angazhimet tona për t'i mundësuar OSHC të ushtrjnë rolet e tyre si aktorë të pavarur të zhvillimit, me në fokus të veçantë në një mjedis lehtësues, në përputhje me të drejtat ndërkombëtare të rena dakord që maksimizojnë kontributin e OSHC në zhvillim.

b) Nxism OSHC të zbatojnë praktika që forcojnë llogaridhënien e tyre dhe kontributin e tyre në efikasitetin e zhvillimit, duke u udhëhequr nga Parimet e Stambollit dhe Korniza Ndërkombëtare për Efikasitetin e Zhvillimit të OSHC-ve.

³ Komunikata nga Komisioni për Parlamentin Europian, Këshillin, Komitetin Ekonomik dhe Social Europian dhe Komitetin e Rajoneve, Rrënjët e demokracisë dhe zhvillimit të qëndrueshëm: Angazhimi i Europës me Shoqërinë civile në marrëdhëniet me jashtë, e datës 12.09.2012. URL:

<http://eur-lex.europa.eu/LexUriServ/LexUriServ.do?uri=COM:2012:0492:FIN:EN:PDF>

⁴ Council Regulation (EC) No 1698/2005, neni 6 dhe Regulation (EU) No 1306/2013 of the European Parliament and of the Council of 17 December 2013, nenet 7 dhe 12.

Në aktivitetin e Tryezës tematike të dt 29 prill në Lakanas dhe Forumin e Agrobiznesit dt. 20 maj 2022 në Lushnje morën pjesë dhe diskutuan përfaqësues nga:

Ministria të Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural, si dhe Turizmit e Mjedisit në vite:

Prof. Lufter Xhuveli, për-



shëndeti në emër të Ministrave të Turizmit dhe Mjedisit në vite, Vlerësoi mënyrën e organizimit dhe iniciativën e KASH për rezultatet e arritura gjatë diskutimeve dobiprurëse në "Tryezën tematike" dhe Forumin e Agrobiznesit, duke sjellë shembuj dobiprurës nga përvoja e gjatë akademike dhe drejtuese në të gjitha hallkat e këtyre sektorëve. Gjithashtu dha disa këshilla të vlefshme për zgjidhjen e problemeve e kapërcimin e vështirësive, për realizimin e kërkesave të Rezolutës.

Prof. Bamir Topi, vlerësoi kapacitetet, dëshirën dhe kontributin e pjesëmarrësve në "Tryezën tematike", punën e mirë që ishte bërë paraprak-

Diskutime në tryezën tematike dhe në forum



isht nga KASH për informimin paraprak të pjesëmarrësve, për kohën dhe vendin e përzgjedhur. Në diskutim u përqendrua dhe dha këshilla të vlefshme për zgjidhjen e problemit të pronave, si një nga pengesat kryesore për realizimin në kohë të shumë kërkesave të rezolutës.

Prof. Rexhep Uka, foli konkretisht dhe demonstroi në



praktikë modelin dobiprurës të kompleksit agroturistik "Uka Farm" të krijuar në vite. Përshëndeti dhe vlerësoi lart punën e personaliteteve që kanë kontribuar në sektorin e bu-

jqësisë në vite, duke veçuar e përmendur veçanërisht Ata që kishin punuar e kontribuar në Lushnje, vendin ku u organizua Forumi i Agrobiznesit. Rëndësi të veçantë për realizimin e kërkesave të rezolutës, Prof. Uka i kushtoi mekanizimit, inovacionit dhe dixhitalizimit, si shumë të nevojshëm për shëndetin dhe mbrojtjen e bimëve dhe prodhimin e produkteve organike.

Prof. Genc Ruli, në diskutimin e tij u përqendrua në



masat që duhen marrë për të zgjidhur problemet në fushën e financimit dhe rritjen e efikasitetit në këtë sektor jetik të Ekonomisë së Ushqimit. Ai foli për rëndësinë që kanë marrëdhëniet dhe bashkëpunimi me Ministrinë e Financës dhe Ekonomisë, veçanërisht gjatë hartimit dhe miratimit të strategjive dhe procesit të hartimit të P/buxhetit afat mesëm dhe afatgjatë. Vlerësoi punën dhe kontributin e KASH për Rezolutën duke premtuar se do të vijojë kontributin e vet për përmirësimin e situatës në sek-

torin e bujqësisë, Turizmit rural dhe Mjedisit në zonat rurale dhe jo vetëm.

Prof. Edmond Panariti, u përqendrua në rëndësinë që ka gjurmueshmëria dhe labora-



torët e kontrollit të cilësisë së lëndëve të para dhe produkteve ushqimore nga fusha në tavolinë. Ai dha disa këshilla të vlefshme për zgjidhjen e problemeve në këtë sektor dhe u angazhua për të kontribuar për gjetjen e zgjidhjeve eficiente të kërkesave të rezolutës. Ai vlerësoi modelin dhe punën që bëhej në kompleksin Agroturistik Uka Farm për mbrojtjen e bimëve dhe prodhimin organik.

Deputeti Agron Duka, si Ministër bujqësie në vite, deputet dhe themelues i kompanisë së suksesshme "AIBA", tërhoqi vëmendjen për rëndësinë që ka bashkëpunimi i sektorit privat me institucionet e arsimit të lartë, me institucionet publike dhe donatorët. Ai u ndal në vlerësimin dhe mbështetjen e sektorit të Bujqësisë, Turizmit rural dhe Mjedisit në zonat ru-



rale dhe theksoi se mbështetja krahasuar me rajonin dhe nevojat e domosdoshme ka qenë e pamjaftueshme nga të gjitha qeveritë, realitet që duhet të ndryshojë dhe të krahasohet me mbështetjen që japin vendet e rajonit për këta sektorë. Ai u angazhua për të ndërmarrë e mbështetur nismat e ndryshme që mund të merren, për të propozuar ligje dhe amendime ligjesh në kuvend, të kërkuara nga sektori privat përfshirë edhe propozimet e bëra në Rezolutë.

Përfaqësues të Ministrisë Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural:

Min. Frida Krifca, shprehu kënaqsinë për pjesëmarrësit e auditorit, për vlerësimin që i kishin bërë ftesës së KASH shumë personalitete me përvojë të spikatur të fushës, drejtues e përfaqësues të rëndësishëm të disa institucioneve të arsimit të lartë, të Ministrisë Turizmit dhe Mjedisit, të institucioneve financiare bankare dhe mikrofinancës, të projekteve të donatorëve, të shoqatave si motra të



KASH etj, për të marrë pjesë dhe për të dhënë kontributin e tyre në këta sektorë jetikë të Ekonomisë së Ushqimit. Ajo Informoi për punën që po bëhej, për arritjet, objektivat dhe sfidat që ka MBZHR për të realizuar aktualisht dhe në të ardhmen. Rëndësi Ministria Krifca i kushtoi procesit të konsultimit publik të draft-strategjisë të Bujqësisë, Zhvillimit Rural dhe Peshkimit 2021-2027. Ajo u kërkoi pjesëmarrësve në "Tryezën tematike" të japnin kontributin e tyre, për të mundësuar hartimin e një strategjie sa më dobiprurëse për sektorët. Gjithashtu u angazhua se personalisht dhe stafi i ministrisë do të analizojnë dhe ndjekin me vëmendje kërkesat dhe konkluzionet e rezolutës së "Tryezës tematike" dhe Forumit të Agrobiznesit.

Zv. Min. Dhimo Kote dhe Zv. Mini. Enio Civici, ndoqën dhe dëgjuan me vëmendje nga fillimi deri në fund të gjitha diskutimet, këshillat dhe mendimet e pjesëmarrësve, kërkesat, propozimet dhe konkluzionet e rezolutës si në "Tryezën

KASH

(Vijon nga faqja 14)

Tryeza Tematike dhe Forumi i Agrobiznesit “Bujqësia, Turizmi Rural dhe Mjedisit në Zonat Rurale në Shqipëri”



në fjalën e saj që u ndoq me mjaft interes në Forumin e



Agrobiznesit, u përqendrua në vlerësimin dhe masat e menjëhershme që Ministria e Turizmit dhe Mjedisit u ka bërë kërkesave dhe propozimeve të shoqatës agroturizmit, konkluzioneve të “Tryezës tematike” dhe Forumit të Agrobiznesit. Ajo vlerësoi se disa nga konkluzionet dhe propozimet e bëra përmes Rezolutës do të mbështeten duke ngritur menjëherë grupin e punës, për të bërë disa përmirësime dhe amendime në VKM dhe akte të tjera nën ligjore.

Drejtoreshë AZHBR Znj. Eranda Selmanaj, u përqendrua në fushën e financimit dhe disbursimit të fondeve grant.



Ajo informoi me detaje për rezultatet e arritura nga AZHBR, në procesin e disbursimit të 100 % të fondeve grant të programuara për Shqipërinë përmes 4 masave të programit të BE IPARD II. Gjithashtu spjegoi gjerësisht situatën e ekurisë së Programit IPARD III, në të cilin janë miratuar 9 masa me një shumë totale prej 146 milion euro grant. Pyetjes që iu drejtua se a ka fonde për të mbështetur realizimin e konkluzioneve të Rezolutës iu përgjigj pozitivisht, “Po fonde kemi”. Drejtorja u angazhua se puna e mirë dhe rezultatet e arritura nga AZHBR do të vijojë me të njëjtin ritëm edhe në të ardhmen.

Përfaqësues nga Ministria e Turizmit dhe Mjedisit:
Zv. ministret e MTM Znj.



Vilma Bello, dhe Znj. Almira Xhembulla, si dhe drejtoreshë Drejtorie Znj. Alma Baze, ndoqën me interes nga fillimi deri fund aktivitetin e “Tryezës tematike” dhe Forumin e Agrobiznesit.
Znj. Almira Xhembulla



2022”. Ajo vlerësoi konkluzionet dhe kërkesat e Rezolutës dhe premtoi se do të jenë në të ardhmen objekt i veprmtarisë së Bashkisë Lushnje.

Përfaqësues nga Institucione të Arsimit të lartë:

Universiteti Bujqësor Tiranë: Prof. Fatbardh Sallaku, Prof. Remzi Keco, Prof. Ilir Kristo,

Rektori i Universitetit Bujqësor, Prof. Fatbardh Sallaku, e konsideroi takimin si mjaft të rëndësishëm, vlerësoi veçanërisht angazhimin dhe vëmendjen që i kushtoi ak-



tivitetit Ministria e Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural, Ministria e Turizmit dhe Mjedisit. Si dhe gjithë institucionet e tjera publike dhe private pjesëmarrës në aktivitet. Ai ritheksoi dhe garantoi për angazhimin personal dhe stafit të UBT për realizimin e kërkesave dhe konkluzioneve që arritën këto aktivitete për institucionet e arsimit të lartë.

Universiteti Polis, Prof. Sherif Lushaj, Prof. Xhimi Hysa.

Dekani i Fakultetit të Bujqësisë dhe Mjedisit në Universitetin Polis Prof. Sherif Lushaj, u përqendrua në fjalën



e Tij në përmirësimin e punës në sektorin e mjedisit në zonat rurale dhe procesin e konsolidimit të tokës. Ai bëri disa propozime konkrete për masat që duhen marrë, për të përmirësuar situatën në këta dy sektor.

Informoi auditorin për rezultatet e arritura nga zbatimi i një Projekti pilot për konsolidimin e tokës në qarkun Fier dhe sugjeroi që zbatimi dhe përgjithësimi i gjetjeve është një ndër format e futjes në rugën e zgjidhjes të procesit të vështrirë të konsolidimit të tokës.

Universiteti Luarasi, Dekani Fakultetit Ekonomik në Universitetin Luarasi Prof. Asc. Dr. Mateo Spaho, vlerësoi pozitivisht aktivitetet e organizuara dhe bashkëpunimin e Universitetit



“Luarasi” me KASH. Aktivitete dhe bashkëpunim që realizohen në kuadër të Memorandumit të nënshkruar disa kohë më parë midis KASH dhe Universitetit “Luarasi”. Idetë, sugjerimet, këshillat e dhëna dhe analiza e situatës e bërë nga prof. Spaho për rritjen e efikasitetit ekonomik në sektorin e bujqësisë dhe jo vetëm përmirësuan ndjeshëm draftin dhe u reflektuan në Rezolutën që u miratua.

Universiteti “Eqerem Çabej” në Gjirokastrë, Prof. Jaho Canaj, Prof. Robert Çela.

Dekani Fakultetit Ekonomik në Universitetin “Eqerem Çabej” në Gjirokastrë, Robert Çela, përshëndeti në Foru-



min e Agrobiznesit në emër të Rektorit Prof. Bektash Mema. Ai u përqendrua në zhvillimin e sektorit të Turizmit Rural dhe përmirësimin e situatës së Mjedisit në zonat rurale. Vlerësoi bashkëpunimin me KASH që po realizohet edhe në kuadër të Memorandumit që është nënshkruar kohë më parë. U angazhua se puna që ka nisur në bashkëpunim me KASH për kualifikimin e stafëve të Shoqërisë të Bashkëpunimit Bujqësor dhe jo vetëm do të vijojë edhe në të ardhmen. Gjithashtu edhe puna e nisur për zbatimin e një modeli dobipurrës kooperimi e koordinimi midis aktorëve

që punojnë në sektorin e Agrobiznesit, Mjedisit dhe Agroturizmit. Sugjerimet e vlefshme të bëra për përmirësimin e draftit të Rezolutës u reflektuan në dokumentin përfundimtar.

Përfaqësues nga Projekte të donatorëve: nga Projekti RisiAlbania: Z. Stephan Joss, Znj. Edlira Muhedini, Z. Gramos Osmanaj, Nga Projekti SRD i GIZ, Z. Klodjan Rama, Përfaqësues nga Zyra e JICA Tiranë Z. Sokol Konomi. Ekspert nga Institucioni financiar i BERZH Z. Ermal Baze.

Drejtori i Projektit RisiAlbania Z. Stephan Joss,



në fjalën e Tij falenderoi organizatorët e “Tryezës tematike” dhe pjesëmarrësit në Forumin e Agrobiznesit, për angazhimin dhe kontributin që po japin për disa sektorë shumë të rëndësishëm të Ekonomisë Ushqimit si bujqësia, Turizmi rural dhe Mjedisit në zonat rurale. Informoi pjesëmarrësit mbi aktivitetin e projektit Risi Albania dhe objektivat që synon të realizojnë në të ardhmen.

Ekspertë me përvojë të spikatur për sektorët e bujqësisë, Turizmit rural dhe Mjedisit në zonat rurale:

Prof. Bahri Musabelliu, Prof. Anila Kopali, Msc. Pandeli Pasko, Z. Behar Gjoni, Znj. Asetila Koestinger, Z. Erion Nako, Z. Kristo Papa, Z. Llambi Pandehi, Znj. Aulona Vezi, Z. Kujtim Kallashi, Z. Andon Rrapokushi, Z. Kujtim Hamza, Z. Sotiraq Zarka, Z. Agim Boja, Z. Mario Kolaci, Znj. Gjelina Bacaj, Znj. Galie Koçi etj.

Prof. Bahri Musabelliu, në fjalën e Tij trajtoi dhe foli konkretisht dhe me detaje për



vështirësitë, problemet dhe propozoi disa zgjidhje konkrete, për përmirësimin e legjislacionit dhe të punës në tërësi, në procesin e kooperimit dhe

koordinimit institucional. Ai falë përvojës dhe experiencës në procesin e kooperimit dhe koordinimit institucional dha një kontribut të madh në hartimin e kërkesave të Rezolutës për të përmirësuar situatën në këtë proces me rëndësi.

Prof. Jani Mavromati, me diskutimet si në “Tryezën tema-



tike” dhe Forumin e Agrobiznesit u përqendrua në rëndësinë që kanë investimet për përpunimin e mbetjeve në tërësi dhe ato të blegtorisë në veçanti dhe procesi deodorizimit në përmirësimin e mjedisit në zonat rurale. Ai bëri disa sugjerime, dha këshilla dhe propozime konkrete që përmirësuan përmabajtjen e Rezolutës.

Msc. Pandeli Pasko, u fokusua në diskutimin e Tij



në problemet e krijuara nga mangësitë e vet ligjit 7501 “Për Tokën Bujqësore” dhe në problemet e shumta që e shoqëruan ligjin gjat zbatimit. Të cilat kanë çuar në parcelizimin e tejskajshëm të tokës bujqësore, në uljen drastike të sipërfaqes së tokës së punuar dhe kultivuar me mjete të teknologjisë bashkëkohore, në reduktim të ndjeshëm të të ardhurave për njësi të sipërfaqes etj. Ai propozoi disa amendime të ligjit 7501 “Për Tokën Bujqësore”, për të izoluar e frenuar pasoja negative akoma më të mëdha në të ardhmen.

Drejtuuesi i Platformës elektronike ABA Online në FED INVEST shk.k Z. Behar Gjoni, diskutoi për kontributin



që po jep FED INVEST për inovacionin dhe dixhitalizim.

KASH

(Vijon nga faqja 15)

Tryeza Tematike dhe Forumi i Agrobiznesit “Bujqësia, Turizmi Rural dhe Mjedisit në Zonat Rurale në Shqipëri”

imin në sektorin e Bujqësisë, Turizmit rural dhe Mjedisit në zonat rurale përmes zbatimit në praktikë të Platformës Elektronike ABA Online. Gjithashtu foli për rezultatet pozitive që ka arritur FED INVEST në financimin e zonave rurale dhe objektivat për të ardhmen.

Drejtuksi i kompanisë së njohur në fushën e ICT “PROTIK” Z. Erion Nako,



në diskutim u përqëndrua në rëndësinë e madhe dhe mundësitë e shumta që egzistojnë aktualisht në Sektorin e bujqësisë, Turizmit rural dhe Mjedisit në zonat rurale, për zbatimin e inovacionit dhe dixhitalizimit, konkluzion ky i arritur mbas një studimi që


kompania PROTİK ka berë me kërkesë dhe mbështetje të Projehtit RisiAlbania.

Ekspertja e njohur në fushën e marketingut Znj. Asetila Koestinger, theksoi gjatë diskutimit rëndësinë e



përgatitjes së specialistëve të marketingut veçanërisht të atyre që merren me eksportin. Ajo solli shembuj konkret për rezultatet pozitive të arritura nga bashkëpunimi i Saj me kompani private eksportuese dhe Universiteti Bujqësor i Tiranës, për përgatitjen dhe kualifikimin e nje grupi studentësh si specialistë për eksportin.


Drejtuksi Qendrës së Menaxhimit të Cilësisë në Kompaninë Doni Fruit Z. Andon Rrapokushi, u përqëndrua gjatë diskutimit në rolin dhe rëndësinë madhe, që ka procesi certifikimit Global Gap



dhe Lokal Gap si dhe ngritja e funksionimi i Qendrave të Menaxhimit të Cilësisë (QMS) në subjektet e prodhimit dhe përpunimit të fruta perimeve. Ai solli shembuj konkretë nga kompania Doni Fruit për dobime dhe leverdinë e madhe që ka investimi kryer në këtë proces.

Eksperti riciklimit të mbetjeve organike dhe pro-

dhimin e plehut organik të pastër Z. Kujtim Hamza, në



diskutim solli përvojën e vet disavjeçare, për teknologjinë dhe modelin e ri që ka zbatuar në procesin e riciklimit të mbetjeve organike dhe prodhimin e plehut organik të pastër.

Sugjerime, këshilla dhe një kontribut me shumë rëndësi veçanërisht për të ardhmen dhanë me angazhimet dhe ndërhyrjet e tyre në Tryezën tematike dhe Forumin e Agrobiznesit edhe drejtues të agjensive publike dhe të Shoqatave si motra të KASH:

Drejtori Agjensisë së Investimeve Z. Sokol Nano

Sekretare Këshillit të Investimeve Znj. Diana Leka

Kryetare Bashkimit të Dhomave të Tregëtisë dhe Industrisë Shqipërisë Znj. Ines Muçostepa,

Sekretari Përgjithshëm i Shoqatës së Bankave Z. Spiro Brumbulli

Sekretare Përgjithshme e Shoqatës Mikrofinancës Brunilda Isaj

Drejtuksi të Projektit CBS Z. Enio Jaço dhe Z. Ergent Pire

Presidenti i Biznes Albania Z. Luan Bregasi

Drejtori Dhomës Kombëtare të Zejeve Z. Koli Sinjari

Kryetari Shoqatës prodhuesve Z. Sokol Kraja

Kryetari Shoqatës Agroturizmit Z. Florian Uka

Drejtuksi Grupit Teknik Global GAP për Shqipërinë Znj. Irjana Gjana

Gjithashtu edhe Drejtues të KASH, përfaqësues të shoqatave anëtare dhe anëtarë të bordit drejtues të tyre, si dhe subjekte agrobiznesi, që punojnë në fushën e Bujqë-

sisë, Turizmit rural dhe Mjedisit në zonat rurale:

Z. Agim Rrapaj, Z. Edmond Gjata, Z. Perlat Sula, Znj. Enida Shena, Z. Flamur Lalo, Z. Jani Mavromati, Z. Ylli Dede, Z. Enver Isufi, Z. Ibrahim Myftaraj, Z. Hazis Sava, Z. Rahman Kasa, Z. Hafuz Domi, Z. Ejup Ahmeti, Z. Tomorr Kërçuku, Z. Agim Sema, Z. Fato Pogoni, Z. Izet Llashi, Z. Hajdar Kuçi, Z. Gazmend Shehi, Z. Luigj Frangaj, Z. Marash Mici, Z. Hasan Halilaj, Z. Spahi Jahja etj.

Përfaqësues biznesi nga Italia të fushës së Bujqësisë, Turizmit Rural dhe Mjedisit:

Dott. Massimo Cerasuolo, Dott. Massimo Ippolito, Dario Alesandro, Ing. Genci Tepelena.

Mbështetje për KASH në organizimin e “Tryezës tematike” të dt. 29 prill 2022, ishte Projekti SRD i GIZ, financim i qeverisë Gjermane, dhe subjekti Agroturistik “UKA FARM” në Laknas, ndërsa për Forumin e Agrobiznesit ishte Projekti RisiAlbania i SDC, financiar nga qeveria Zvicereane, mbështetje që KASH dhe gjithë pjesëmarrësit në të dy aktivitetet e vlerësuan si mjaft dobiprurëse.

Forum i Agrobiznesit me temë “Bujqësia, Turizmi Rural dhe Mjedisit në Zonat Rurale në Shqipëri” u mbajt në datën 20 Maj 2022, në sallën e teatrit “Vaçe Zela” në Lushnje, gjatë Panairit “Ditët e Bujqësisë” të organizuar nga Iceberg Exhibitions në datat 19-21 Maj. Panairi “Ditët e Bujqësisë” një platformë unike komunikimi me biznesin dhe për biznesin, synon të mbahet çdo vit në zona të Shqipërisë me rëndësi jetike për bujqësinë Shqiptare. Synimi i Iceberg Exhibitions është të organizojë një aktivitet periodik me ndikim të thellë në sektor por që gjithashtu çon “jetë” në qytete të tjera të vendit dhe jo vetëm në Tiranë.

Forum i Agrobiznesit u organizua nga Këshilli i Agrobiznesit Shqiptar nën tematikën “Bujqësia, Turizmi Rural dhe Mjedisit në Zonat Rurale” dhe me fokus kryesor diskutimi mbi: Procesin e Kooperimit dhe Koordinimit, Fushën e Mekanizimit, Inovacionit dhe Dixhitalizimit, Fushën e Financimit dhe Disbursimit të Fondeve Grant, Fushën e Përmirësimit të Legjislacionit dhe Përafrimit me atë të BE-së.



Forum i Agrobiznesit që u mbajt gjatë Panairit “Ditët

e Bujqësisë” në “kryeqytetin” e bujqësisë Lushnje, mbledhi aktorët më të rëndësishëm të qeverisë shqiptare, autoritetet më të larta të Ministrisë së Bujqësisë e Zhvillimit Rural dhe Ministrisë së Turizmit e Mjedisit, shoqatave dhe bizneseve në sektorët e lartpërmendur. Jo vetëm, por edhe përfaqësues të projekteve ndërkombëtare, donatorë, ekspertë me përvojë të spikatur për tematikën që do të trajtohet në forumin mbi bujqësinë, turizmin rural dhe mjedisin në zonat rurale, ishin pjesë e këtij takimi të rëndësishëm në datën 20 Maj në qytetin e Lushnjes.

Bujqësia, Turizmi Rural dhe Mjedisit në Zonat Rurale janë dhe do të vijojnë të jenë edhe në të ardhmen sektorë me kontribute e potenciale të mëdha, me rëndësi të veçantë, në fushën e Ekonomisë së Ushqimit. Ata janë sektorë jetikë, për rolin dhe rëndësinë që kanë, për rritjen e të ardhurave

të familjeve fermerëve, për punësimin gjithëvjetor të tyre

dhe sigurimin e ushqimit, për rritjen e eksporteve dhe reduktimin e importit të produkteve ushqimore, si dhe për zhvillimin e qëndrueshëm të zonave rurale në tërësi. Gjithashtu janë sektorë me shumë ndikim, për forcimin dhe konsolidimin e sigurisë kombëtare, veçanërisht në kohë krize.



Rekomandime dhe propozim për masa konkrete

Në secilën nga fushat e lartpërmendura, synohen të arrihen objektiva të prekshme në kuadër të kërkesave konkrete ndaj institucioneve kryesore të cilat i ndikojnë drejtpërdrejt sektorët në fjalë. Referuar kooperimit dhe koordinimit të punës, deri tani është vlerësuar

më shumë teorikisht, si një potencial shumë dobiprurës, por i pashfrytëzuar sa dhe si duhet në praktikë. Konsiderohet si një mundësi reale, për të sjellë një bashkëpunim më eficient midis hallkave në sektorin e Bujqësisë, Turizmit rural dhe Mjedisit në Zonat rurale. Objektivi i këtij Forumi të Agro-

biznesit në këtë këndvështrim ishte marrja e masave konkrete, për ndryshimin e formës aktuale të organizimit të punës. Projekt-Rezoluta e përgatitur nga KASH u prezantua gjatë forumit që u mbajt në datën 20 Maj në Lushnje, në kuadër të Panairit “Ditët e Bujqësisë” propozoi rekomandime konkrete në këtë aspekt. Mekanizimi, Inovacioni

dhe Dixhitalizimi në sektorët e Bujqësisë, Turizmit Rural dhe Mjedisit në Zonat Rurale,



janë instrumente eficientë dhe rruga e duhur për të ulur koston, rritur rendimentin, për të përballuar edhe mungesën e fuqisë punëtore në këta sektorë dhe jo vetëm dhe veçanërisht në këtë situatë krize që është ekonomia e vendit. Për sa i përket Inovacionit dhe Dixhitalizimit, MBZHR i ka përcaktuar si një ndër objektivat prioritare të Strategjisë për Zhvillimin Bujqësor e Rural dhe Peshkimin 2021-2027. Shqipëria për përdorimin e inovacionit dhe dixhitalizimit e ka aprovuar tashmë një kuadër ligjor bashkëkohor. Platforma elektronike si ABA Online e institucioni financiar FED Invest mbështetur nga JICA, platforma elektronike Agroweb e projektit CBS mbështetur nga USAID, platforma elektronike VodafoneSmart Agriculture, e zbatuar nga kompania Doni Fruits etj. janë arritjet kyçe në

këtë drejtim. Referuar financimit dhe disbursimit të fondeve Grant, vlerësohet se aktualisht jemi përpara fakteve, që për sektorin e bujqësisë dhe turizmit rural, nga sektori privat kemi akoma inisiativa, dëshirë, por edhe burime të konsid-

erueshme për financim përmes remitancave dhe burimeve të tjera të brendshme të subjekteve private. Banka e Shqipërisë dhe bankat e nivelit të dytë kanë filluar të ndryshojnë politikën, duke programuar më shumë fonde të mundshme, për t'u përdorur si kredi për zhvillimin e bujqësisë dhe mbështetjen e subjekteve, që operojnë në zonat rurale në sektorin e agroturizmit.

Së fundmi, gjatë Forumit të Agrobiznesit me tematikë “Bujqësia, Turizmi Rural dhe Mjedisit” që u mbajt në datën 20 Maj në sallën e teatrit “Vaçe Zela” në Lushnje, gjatë Panairit “Ditët e Bujqësisë” të organizuar në sheshin përpara Bashkisë Lushnje, u prezantuan rekomandime konkrete edhe në lidhje me përmirësimin e kuadrit ligjor dhe përafrimin e tij me standartet e BE-së.